


KOMUNA ARRAS, QARKU DIBËR

Strategjia afatmesme e zhvillimit

2008–2015



Ky plan strategjik është hartuar nga disa grupe palësh të interesuara nga Komuna Arras nën drejtimin dhe këshillimin e eksperëve të FLAG. FLAG nuk mban përgjegjësi për përmbajtjen e strategjisë, ndërkohë që përgëzon komunën dhe personat e përfshirë për cilësinë e punës së bërë.





Copyright © 2008 Komuna Arras, Qarku Dibër

*Paraqitja grafike dhe shtypi
Maluka shpk*

Tabela e përmbajtjes

I.	Parathënie.....	5
II.	Metodologjia e përdorur.....	6
III.	Përfitimet e pritshme nga zbatimi i planit	10
IV.	Zbatimi i planit.....	11
V.	Vizioni dhe synimet.....	12
VI.	Sondazh i biznesit vendor	14
VII.	Historik i shkurtër i komunës.....	15
VIII.	Tendencat e zhvillimit sipas sektoreve.....	18
IX.	Analiza SWOT	25
X.	Matrica e planit strategjik.....	30
XI.	Formularët sipas fushave të zhvillimit	34
XII.	Fish-Projekte	45
Shtojcat		
	Shtojca 1: Vendimi i Këshillit Komunal për miratimin e PSZhEV	63
	Shtojca 2: Analiza e anketimit me biznesin vendor.....	64



I. Parathënie

Përsëritet kontributin e të gjithë atyre që morën pjesë në përpilimin e Strategjisë së Zhvillimit të Komunës sonë. Pjesëmarrja e gjerë dhe analizimi i të gjithë faktorëve pozitivë e negativë e bënë këtë dokument të rëndësishëm dhe të qëndrueshëm.

Planifikimi i veprimeve për të ndërtuar të ardhmen e përbashkët konsiderohet si detyrë e brezave në mënyrë që komuna jonë të zhvillohet pa ndërprerje e me ritme të shpejta për të arritur nivele të larta jetese.

Mirëkuptimi dhe kontributi direkt i të zgjedhurve vendorë në realizimin e këtij dokumenti është jo vetëm shprehje e cilësive më të mira të banorëve të kësaj zone por është edhe një garanci për zbatimin e asaj që ne bashkërisht planifikim për një periudhë afatmesme.

Gjej rastin të falenderoj qeverinë holandeze që nëpërmjet SNV-së dhe bashkëpunimit të frytshëm me qarkun e Dibrës e FLAG, mundësuan realizimin e kësaj Strategjie me metoda bashkëkohore.

Ju bëj thirrje që ta konsiderojmë Strategjinë e Zhvillimit Afatmesëm 2008–2015 të Komunës Arras si hapin e parë të sigurtë për zhvillimin me ritme të shpejta të Komunës e të gjithë zonës sonë.

Atë që planifikim bashkërisht, lypset ta zbatojmë bashkërisht duke bashkëpunuar dhe kontribuar secili sipas mundësive por me përkushtim dhe dashuri në emër të së ardhmes sonë e të fëmijëve tanë.

Të gjithë ata që e lexojnë këtë dokument dhe kanë dëshirën dhe mundësinë për të kontribuar sadopak janë të mirëpritur për t'iu bashkangjitur përpjekjeve tona. Jam i sigurt se komuniteti i Arrasit do t'i vlerësojë maksimalisht, jo vetëm për atë çka do të bëjnë por edhe për qëllimin fisnik që ata shprehin duke marrë në konsideratë nevojat tona për zhvillim.

SALI TËRSHALLA
KRYETARI I KOMUNËS ARRAS

II. Metodologjia e përdorur

Metodologjia që mundëson një proces efektiv të hartimit të PSZhEV është nëpërmjet planifikimit strategjik me pjesëmarrjen e komunitetit. Çështja e zhvillimit ekonomik duhet të paraqitet si problem për t'u zgjidhur, nevoja për t'u adresuar dhe mundësitë për t'u përdorur. Proçesi që u zbatua mundësoi njësimin e opinioneve dhe zgjedhjeve të qeverisë komunare me ato të biznesit dhe të përfaqësuesve të komunitetit.

Hapat dhe veprimet në procesin e zhvillimit të Vizionit dhe Planit Strategjik të Komunës, kanë patur parasysh se Vizioni është deklarata e përbashkët për të ardhmen e komunitetit dhe aktorëve të tjerë të komunës dhe se Plani Strategjik tregon rrugën dhe përqsjet se si do të bëhet realitet Vizioni. Ai specifikon synimet kryesore, objektivat, programet dhe projektet që do të mundësojnë arritjen e Vizionit. Plani merr parasysh buxhetin vendor, burimet njerëzore dhe çështjet ligjore që ndikojnë në zbatimin e tij.

Vetë procesi i hartimit të Vizionit dhe Planit ofroi përfitime për komunitetin si: a) Bashkimin e komunitetit, b) Identifikimin e mundësive të reja për të ardhmen, c) Nxitjen e përfshirjes së banorëve në qeverisjen vendore, d) Zhvillimin e cilësisë së udhëheqjes së Komunës, e) Sigurimin e një baze më të mirë për planifikimin dhe vendimmarrjen dhe f) Inkurajimin e përmirësimit të punës në partneritet për planifikim strategjik.

Gjatë fazave të mëposhtme u realizuan këto aktivitete:

Faza e përgatitjes

- Sigurimi i angazhimit politik të Kryetarit dhe pjesëtarëve të tjerë të saj
- Krijimi i Komisionit të Planit Strategjik, i kryesuar nga Kryetari i komunës
- Seleksionimi i drejtuesit të projektit dhe stafit të projektit
- Caktimi i temave dhe ngritja e grupeve përkatëse për të mbështetur projektin
- Sigurimi i një ekspertize të jashtme
- Hartimi dhe miratimi i planit të punës për hartimin e PSZhEV
- Përpilimi i një liste të aktorëve të mundshëm për t'u angazhuar në proces
- Informimi i agjencive të qeverisë qendrore, të qarkut dhe njësive vendore fqinje për bashkëpunim

Faza 1

- Përzgjedhja e të dhënave për t'u mbledhur dhe burimi i tyre
- Mbledhja e të dhënave nga burimet e identifikuar
- Analizimi i të dhënave për të identifikuar tendencat kryesore të zhvillimit në komunë
- Krahasimi i të dhënave
- Përgatitja e raportit me karakteristikat kryesore të zonës
- Realizimi i sondazhit me biznesin vendor
- Bërja e analizës SWOT duke patur si referencë edhe profilin e komunës

Faza 2

- Fuqizimi i angazhimit të palëve të interesuara
- Analiza e tendencave të zhvillimit duke përdorur mbledhje të zgjeruara të Komisionit të Planit Strategjik dhe rezultatet e sondazhit me bizneset
- Analizimi i gjetjeve nëpërmjet metodikës “stuhi idesh e mendimesh” (brainstorming)

Faza 3

- Draftimi i një Deklarate Vizioni, e cila përshkruan synimin e komunitetit, ku dallohet në mënyrë sintetike se si do të jetë komuna duke përdorur imagjinatën dhe kreativitetin bazuar në realitetin objektiv, të dhënat e grumbulluara rreth komunës, konsultimet me komunitetin dhe analizën e tendencave. Këtu dallohen anët e forta dhe mundësitë e identifikuar të zonës ku ndodhet komuna.
- Zhvillimi i analizës SWOT, synimi i së cilës është specifikimi i anëve të forta dhe të dobëta si cilësi të brendshme të komunitetit si dhe mundësitë e rreziqet që shkaktohen nga faktorë të jashtëm. Zhvillimi i analizës SWOT bazohet në të dhënat dhe informacionet e grumbulluara rreth komunës dhe të ardhmes së saj. Analiza u zhvillua nëpërmjet grupeve, mbledhjeve të komunitetit, duke përdorur teknikën “stuhi idesh e mendimesh” (brainstorming) dhe të tjera teknika konsultimesh të lehtësuara nga eksperti.
- Finalizimi i Deklaratës së Vizionit pas realizimit të analizës SWOT dhe testimit të saj nëpërmjet grupeve dhe/ose mbledhjeve të komunitetit. SWOT përdoret si bazament për krijimin e Vizionit.

Faza 4


- Me krijimin e Deklaratës së Vizionit nisja e punës për identifikimin e mënyrave për ta arritur Vizionin nëpërmjet Planit Strategjik duke përcaktuar “si do të shkojmë atje?”
 1. U identifikuan synimet që janë më përshkruese dhe specifikuere se ku duam të shkojmë
 2. Për çdo synim u përcaktuan objektivat për arritjen e tij
 3. Për çdo objektiv u identifikuan programe të mundshme
 4. Për çdo program u identifikuan projekte të mundshme

Projektet u paraqitën në formën e Fish-Projekteve, me ndihmën e të gjithë të angazhuarve, ku parashikohen implikimet financiare të burimeve njerëzore dhe ato të kuadrit ligjor, duke patur parasysh: a) vlerësimin nëse çdo projekt është realist dhe i arritshëm dhe se kush do të sigurojë burimet (financiare, njerëzore) për zbatimin e tij dhe b) përgjegjësinë në zhvillimin e projekt-propozimit.

- Përgatitja e draft-versionit final të materialit dhe miratimi në Këshillin e Komunës me vendim të veçantë

Mbetet detyrë e të gjithë aktorëve përfshirja në procesin e monitorimit dhe të vlerësimit të progresit gjatë zbatimit të Planit Strategjik.

Komisioni i Planit Strategjik të Komunës Arras



III. Përfitimet e pritshme nga zbatimi i Planit

Përfitimet që priten si rezultat i zbatimit të Planit tonë Strategjik të Zhvillimit janë të shumëfishta, por më kryesoret janë:

- Orientimi i Këshillit dhe administratës së Komunës në procesin e buxhetimit vjetor dhe afatmesëm duke u fokusuar në zbatimin e projekteve të përfshira në PSZh
- Fokusimi tek burimet njerëzore dhe financiare në fushat e identifikuara në Plan duke rritur maksimalisht përfitimet dhe mundësuar arritjen e synimeve dhe objektivave të PSZh
- Fuqizimi i partneritetit në vendimmarrje dhe bashkëfinancim mes qeverisë komunare dhe komunitetit të biznesit, qeverisë qendrore dhe donatorëve
- Rritja e kapaciteteve të administratës së bashkisë në zbatimin e një Plani Strategjik Zhvillimi
- Koordinimi i aktiviteteve të organizatave dhe institucioneve të cilat paraqesin interes në zbatimin e PSZh
- Dokumentimi i ecurisë së zhvillimit ekonomik në komunë duke përdorur formularët e sektorëve të zhvillimit
- Identifikimi i rezultateve të pritshme dhe krijimi i një sistemi monitorues në bashkëpunim me komunitetin, me qëllim ndjekjen e aktiviteteve dhe vlerësimin e rezultateve të parashikuara nga PSZh
- Zhvillimi i një sistemi eficient komunikimi mes qeverisë komunare dhe partnerëve të saj
- Lehtësimi i marketimit të potencialeve dhe të mundësive të të bërit biznes në komunë
- Përmirësimi i sistemit të menaxhimit në komunë në funksion të zbatimit të programeve dhe projekteve të PSZh
- Orientimi i qeverisë qendrore dhe donatorëve në dhënien e fondeve dhe në përqendrimin tek burimet ekzistuese të disponueshme
- Arritja e ndryshimeve konkrete në përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe mundësive ekonomike për komunitetin

IV. Zbatimi i Planit

Ky është Plani Strategjik zyrtar për qeverinë komunare, institucionet dhe ndërmarrjet që ka nën varësi. Duke qenë se afati i zbatimit të Planit është më i gjatë se mandati politik, sukcesi i zbatimit të tij do të varet shumë nga angazhimi i vazhdueshëm i qeverisë komunare dhe partnerëve tanë në arritjen e objektivave dhe zbatimin e projekteve të përvijuara.

Këshilli Komunal, si faktori kyç në mbështetjen e PSZh, do të garantojë dhënien e fondeve për financimin e projekteve si edhe do të diskutojë dhe miratojë përmirësimet që do të sugjerohen nga Komisioni i Planit Strategjik dhe Kryetari i komunës.

Kryetari i komunës dhe personi direkt përgjegjës në administratë për ndjekjen e zbatimit të Planit Strategjik do të nxisin dhe koordinojnë përpjekjet, programet, projektet dhe financimet e qeverisë qendrore, donatorëve dhe organizatave vendase dhe të huaja në mënyrë që ata të ndjekin dhe mbështesin zbatimin e Planit. Përveç kësaj, Kryetari do të iniciojë dhe realizojë përmirësimet e nevojshme në menaxhimin e proceseve të punës dhe do të ristrukturojë stafin në funksion të zbatimit të Planit .

Sukcesi i zbatimit të Planit do të varet më së shumti edhe nga mënyra se si organizatat dhe agjencitë e interesuara apo përfshira në zbatimin e Planit Strategjik do të menaxhojnë elementë të veçantë për të cilët ata janë përgjegjës.

V. Vizioni dhe synimet

VIZIONI

Qëllimi i përcaktimit të Vizionit për zhvillimin e komunës është që t'i mundësojë komunitetit tonë të artikulojë se ku ai dëshiron të jetë në të ardhmen dhe çfarë rruge do të ndjekë për të arritur të ardhmen e dëshiruar. Vizioni do t'i japë komunitetit dhe qeverisë komunare një ide të qartë se ku duhen përqendruar energjitë dhe burimet e tyre.

Vizioni u zhvillua nga Komisioni i Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Komunës (KPZhS) pas konsultimeve me segmente të ndryshme të komunitetit. Synimi është që Vizioni të zhvillohet dhe të pranohet nga sa më shumë aktorë dhe grupe interesi si edhe të sigurojë një udhërrëfim të qartë drejt të ardhmes së komunës Arras.

Ne besojmë se Vizioni i formuluar përmbledh në mënyrë realiste ambiciet, dëshirat dhe kapacitetet e komunës sonë. Ky Vizion do të jetë objekt rivlerësimi nga komuniteti, duke përfshirë vendimmarrësit në qeverinë vendore, për të reflektuar zhvillimet, ndryshimet dhe ndikimet në komunë.

VIZIONI I KOMUNËS ARRAS

Në vitin 2015 Komuna e Arrasit do të jetë një nga prodhuesit, përpunuesit dhe tregtuesit më të suksesshëm në qarkun e Dibrës për prodhimet tradicionale bazuar kryesisht në burimet dhe potencialet e komunës.

SYNIMET

Përcaktimi i synimeve të ZhEV na ndihmon të marrim vendime lidhur me rrugët dhe mënyrat për të arritur ambiciet dhe ndryshimet që nevojiten. Megjithëse disa nga synimet dhe veprimet për arritjen e tyre nuk lidhen direkt me krijimin e vendeve të punës dhe me zhvillimin dhe tërheqjen e bizneseve, e ardhmja e komunitetit tonë bazohet mbi themele të shëndosha si niveli i arsimimit dhe cilësia e jetesës, infrastruktura dhe shërbimet komunale. Në konceptin tonë, bizneset nuk zhvillohen, nuk lulëzojnë dhe nuk mund të tërhiqen në komunitete, kur nuk ofrohen nivele dhe cilësi të përshtatshme të infrastrukturës dhe shërbimeve që kërkon një mjedis i mirë për zhvillimin e biznesit.

Për të arritur synimet e ZhEV, komuna jonë është përqendruar në përdorimin e burimeve të veta natyrore dhe njerëzore. Për zhvillimin e synimeve, Komisioni i Planit Strategjik mori parasysh mundësitë dhe sfidat me të cilat ballafaqohet komuna, historinë e vet të zhvillimit ekonomik dhe të rajonit.

Synimet e ZhEV shprehin drejtimet kryesore që do të ndjekë zhvillimi i komunës. Këto janë renditur më poshtë sipas rëndësisë për zhvillimin vendor dhe krijimit të një mjedisi të favorshëm për zhvillim të qëndrueshëm . Ato janë zhvilluar nëpërmjet një analize logjike të kujdesshme të Vizionit dhe trajtojnë çështje thelbësore për zhvillimin e komunës.

Matrica në vazhdim prezanton në mënyrë të organizuar Strategjinë e Zhvillimit, nga Vizioni tek Projektet, duke mundësuar një fotografim të ambicieve, përpjekjeve dhe iniciativave të komunitetit dhe qeverisë komunare që mundësojnë zbatimin e Strategjisë dhe zhvillimin ekonomik të komunës.

Synimi 1:

Mbështetja e zhvillimit ekonomik të planifikuar me sisteme infrastrukturash publike të ndërtuara në nivele që adresojnë nevojat dhe i paraprijnë zhvillimit të veprimtarive private e publike cilësore.

Synimi 2:

Kthimi i Arrasit në një zonë ku bizneset ruhen, rriten e zhvillohen në sektorët e prodhimit, përpunimit e tregtimit të produkteve, kryesisht tradicionale dhe ku mundësitë dhe burimet shfrytëzohen në mënyrë racionale për të nxitur shërbime cilësore dhe turizëm.

Synimi 3

Arritja e standarteve bashkëkohore të shërbimeve publike në një klimë bashkëpunimi të ngushtë mes komunitetit dhe qeverisë së mirë komunare.

VI. Sondazh i Biznesit Vendor

Ne komunën Arras u realizua një sondazh me biznesin vendas për të kuptuar më mirë shqetësimet, pritshmëritë dhe nevojat e biznesit. Synimi i sondazhit ishte mbledhja e informacionit të sistemuar mbi vlerësimin e komunitetit të biznesit në lidhje me situatën ekonomike në komunë, perspektivën e të bërit biznes në komunë, kushtet dhe rregullat që ndikojnë në zhvillimin e bizneseve vendase, politikat dhe praktikrat që pengojnë zhvillimin e bizneseve ekzistuese, si edhe kërkesat dhe nevojat e komunitetit për përmirësimin e klimës së biznesit.

Sondazhi mbi Klimën e Biznesit u zhvillua në muajin Nëntor 2007 dhe në të morën pjesë 25 biznese nga kategori të ndryshme. Perceptimi kryesor i bizneseve është se qeveria komunare nuk ka mjetet dhe autoritetin e duhur për të ndihmuar zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Ky perceptim mund të jetë shkak i komunikimit dhe dialogut të varfër midis qeverisë komunare dhe biznesit.

Gjatë diskutimeve, përfaqësuesit e biznesit shprehën dëshirën që të viheshin në dispozicion më shumë burime financiare për autoritetet vendore, në mënyrë që të rritej kapaciteti dhe mundësia e tyre për të përkrahur zhvillimin ekonomik në komunë.



**Analiza e sondazhit të bërë me biznesin prodhues,
përpunues e tregtues**

Përfshirja e opinionëve të biznesit në formulimin e Planit Strategjik ishte një hap i rëndësishëm në hapjen e procesit të vendimmarrjes. Nëpërmjet këtij hapi, u shqyrtuan opinionet e një grupi njerëzish me influencën më të madhe mbi zhvillimin ekonomik në komunë.

VII. Historik i Shkurtër i Komunës

Komuna e Arrasit ndodhet në pjesën veriperëndimore të qarkut të Dibrës. Ajo ka një sipërfaqe rreth 70 km² dhe përbëhet nga 9 fshatra me një popullsi rreth 5600 banorë. Arrasi shtrihet në pjesën perëndimore të lumit Drin i Zi nga kuota 380 m mbi nivelin e detit deri në kuotën 1800 m, në malet e Pllajës dhe të Rujës.

Territori i komunës është një vendbanim i hershëm dhe i përket zonës së Çidhnës, emër të cilin mban edhe fshati më i madh i komunës. Ekzistojnë gjurmë të ndryshme që vërtetojnë banimin dhe shenja të tjera zhvillimi të konsiderueshëm në periudha të ndryshme të kësaj zone.

Kjo zonë konsiderohet si qendra e Principatës së Kastriotëve dhe vendlindja e heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti (Skënderbeu). Të dhëna më të hollësishme mund të merren nga materialet e Muzeut Historik si edhe nga vepra e Marin Barletit “Historia e Skënderbeut”.

Pozicioni gjeostrategjik, klima e përshtatshme, toka pjellore, ekzistenca e ujërave natyrore dhe gjelbërimi natyral ka bërë që historikisht kjo zonë ta bazojë ekonominë e saj në produktet bujqësore dhe blegtorale. Larmia e mikroklimave dhe pozicionimit të tokave në lartësi dhe në shtrirje ka lejuar dhe lejon kultivimin e gati të gjitha llojeve të produkteve bujqësore dhe blegtorale.

Nga pikëpamja e administrimit, pas instalimit të regjimit totalitar, kjo zonë u kthye në kooperativë me drejtim bujqësor dhe blegtoral. Pas viteve ‘90 dhe kryerjes së reformave për kthimin e tokave, familjet e zonës filluan organizimin e mikroekonomive të tyre dhe administrimin e tyre në mënyrë jo të organizuar dhe në bashkëpunim të dobët ndërmjet tyre. Ndryshimet i gjetën të papërgatitur fermerët dhe me mundësi të vogla për kryerje investimesh. Tregu privat i pakonsoliduar, largësia nga qendrat me popullsi të dendur, infrastruktura e rënduar dhe emigrimi u bënë faktorë shtesë negativë për rënien e prodhimit të përgjithshëm duke shkuar drejt prodhimit kryesisht vetëm për nevoja familjare.

Sot banorët e kësaj zone gjithnjë e më shumë po bëhen të ndërgjegjshëm për shfrytëzimin maksimal të mundësive që realisht ekzistojnë apo mund të aktivizohen si edhe për shmangien e dobësive në mënyrë që aktivitetet e tyre ekonomike të zhvillohen në mikroferma dhe aktivitete prodhimi, përpunimi dhe tregtimi me rezultat ekonomik të favorshëm dhe me norma të larta fitimi.

TË DHËNA TEKNIKE MBI KOMUNËN

<i>Gjendja teknike e infrastrukturës publike nën juridiksionin e komunës</i>		<i>Investimet Prioritare të Evidentuara (të renditura sipas rëndësisë)</i>	
1. Rrugë rurale	gjithsej	Nr	EMËRTIMI I INVESTIMIT
Të rikonstruata	84		Kosto (Lekë)
Të rikonstruata	4	1	Ndërtim i qendrës komunitare+sistemim-asfaltim i qendrës së komunës
Të parikonstruata	80	2	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Grykë Nokë
2. Rrugë urbane	0	3	Rikonstruksion i shkollës së mesme Arras
Të rikonstruata	0	4	Ndërtim ujësjellësi në fshatin Sinë
Të parikonstruata	0	5	Asfaltim i rrugës Zall Sinë-Sinë
3. Ujësjellësa	4	6	Asfaltim i rrugës Çidhën-Grykë Nokë
Të rikonstruuar		7	Asfaltim i rrugës Arras-Çidhën
Të parikonstruuar		8	Asfaltim i rrugës Arras-Mustafë-Gur i Zi
4. Shkolla	12	9	Ndërtimi i kanalizimit të ujërave të zeza Çidhën
a) Të rikonstruata	4	10	Asfaltim i rrugëve në fshatin Arras
Sipërfaqe ndërtese	540	11	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Sinë
Sipërfaqe oborri	10.113	12	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Mustafë
b) Të parikonstruata	8		
Sipërfaqe ndërtese	1986		
Sipërfaqe oborri	22.844		
5. Qendra Shëndetësore	6		
Të rikonstruata			
Të parikonstruata			
6. Kanalizime të ujërave të zeza			
Të rikonstruata			
Të parikonstruata			
7. Kanale ujftëse	50		
Të rikonstruata	20		
Të parikonstruata	30		
8. Tregje publike	0		
Të rikonstruata	0		
Të parikonstruata	0		
9. Parqe & hapësira të gjelbërta	3.000		
Të rikonstruata			
Të parikonstruata	3.000		


VIII. Tendencat e zhvillimit sipas sektorëve

1. Të dhëna të përgjithshme:

- Qarku i Dibrës ka një dendësi mesatare 73,4 banorë/km² kurse komuna Arras 96 banorë/km².
- Pas viteve '90 popullsia e Qarkut Dibër është zvogëluar me mesatarisht 16% për shkak të emigrimit jashtë vendit dhe migrimit brenda vendit. Nga llogaritja e familjeve të larguara nga komuna del se ato përbëjnë aktualisht rreth 6,7% të popullsisë së komunës.
- Në qarkun e Dibrës trajtohen me ndihmë ekonomike afërsisht 21% e familjeve kurse në komunën e Arrasit aktualisht 40% e familjeve trajtohen me ndihmë ekonomike.
- Nga e gjithë sipërfaqja e komunës, 23% është tokë bujqësore, 57% pyje e kullota. Mesatarisht, toka bujqësore për çdo familje është në shifrën 0,91 ha/familje kurse në rang qarku kjo shifër është 0,94 ha/familje.
- Burimet e të ardhurave të familjeve kryesisht vijnë nga ndihma ekonomike, nga shitje të produkteve të tepërta në mënyrë jo të organizuar, nga emigracioni dhe punësimi apo vetëpunësimi. Të ardhurat për frymë në ditë nuk mund të llogariten saktësisht por afërsisht arrijnë në 130 lekë për frymë në ditë.

2. Administrimi dhe qeverisja vendore

Administrata e Komunës ARRAS përbëhet nga 13 punonjës të inkuadruar sipas skemës së mëposhtme organizative:



3. Bujqësia

Në komunën e Arrasit, për prodhimet bujqësore sot janë të mundshme për përdorim rreth 1200 ha tokë, me një mundësi shtimi të saj deri në 1240 ha.

Për drurët frutorë ka 40 ha dhe mund të shtohet kjo sipërfaqe në 150 ha. Sipërfaqja e vreshtave është 9 ha dhe mund të shkojë deri në 15 ha. Sipërfaqja e shfrytëzuar për kullota është 277 ha. Për foragjeret shfrytëzohen rreth 48 ha tokë. Afërsisht prodhohen 40 ton perime dhe 100 ton fruta të ndryshme por nuk ka aktivitete për përpunimin e tyre. Ekzistojnë rreth dhjetë makina bujqësore dhe dyzet automjete transporti për pasagjerët dhe mallrat.

Rreth 60% e familjeve tregtojnë teprica prodhimi në sasi të vogla. Këto prodhime kryesisht janë fasule (rreth 200 kv), misër (rreth 500 kv), mollë (rreth 300 kv), rrush (rreth 200 kv), foragjere (rreth 300 kv) dhe sasi të vogla perimesh të ndryshme, patate etj. Në treg gjithashtu dalin bimë medicinale të mbledhura nga familjet e komunës dhe kryesisht sherbelë (rreth 500 kv), trumëz (rreth 300 kv), lule agulice (rreth 20 kv), lajthi e egër (rreth 150 kv) dhe bimë të tjera medicinale në sasi të vogla.

Duke u nisur nga tradita e prodhimeve bujqësore ekzistojnë mundësitë e rritjes së prodhimit për treg të prodhimeve si misri, molla, dardha, qershia, fasulja, rrushi, etj. Ka tendenca për kultivimin e lajthisë së butë e cila është evidentuar si një prodhim që mund të kultivohet me sukses dhe që ka treg të leverdisshëm.

Këto prodhime janë të mundshme nëse rikonstruktohet sistemi vaditës, shtohen mundësitë me anë të kredimarrjes së mekanikës bujqësore si edhe trajnohen fermerët për krijimin e sipërfaqeve të reja me këto prodhime, krahas futjes së bimëve me rendiment të lartë.

Një tjetër veprim që duhet kryer është organizimi dhe sigurimi i tregut të prodhimeve të pritshme. Gjithashtu mund të mendohet për krijimin e një tregu zonal për prodhimet bujqësore.

4. Blegtoria

Sot në komunën e Arrasit ka rreth gjashtë mijë e gjashtëqind bagëti të imta dhe një tendencë rritjeje deri në shtatë mijë krerë të imta (dhi dhe dele). Numri i krerëve të gjedhit është një mijë e pesëqind e pesëdhjetë e katër dhe mund të shkojë deri në një mijë e shtatëqind krerë. Rriten shpendë të ndryshme, kryesisht pula (gjithsej rreth katër mijë e shtatëqind krerë) dhe ekziston mundësia e rritjes së këtij numri deri në gjashtë mijë krerë.

Në këtë komunë rriten bletë dhe prodhohet rreth 10 kv mjaltë, sasi e cila mund të dyfishohet. Gjithashtu, rritet peshk troftë në një impiant privat që aktualisht prodhon 70–100 ton peshk dhe mund të rrisë prodhimin në të ardhmen.

Rreth gjashtëqind familje të komunës tregtojnë produkte blegtorale. Në treg nxirret rreth 300 kv mish viçi dhe 200 kv mish keci dhe qingji. Qumështi nuk del në treg, pasi transporti është i vështirë dhe i kushtueshëm. Qumështi përpunohet dhe në treg del rreth 100 kv gjizë e 10 kv gjalpë.

5. Infrastruktura rrugore

Infrastruktura rrugore është në një nivel që le shumë për të dëshiruar dhe në një masë të konsiderueshme bëhet faktor pengues i biznesit prodhues e tregtues. Për të shkuar në qendër të komunës duhen përshkuar 22 km nga qyteti i Peshkopisë, gjysma e së cilës është e paasfaltuar dhe në gjendje të keqe. Në të gjithë territorin e komunës ka 84 km rrugë rurale, ku vetëm 13 km janë të rikonstruara . Ka 66 km rrugë të brendshme. Përmirësimi i situatës mendohet të fillojë me shtrimin me asfalt të segmentit të rrugës nacionale Peshkopi–Muhurr.

Gjendja e rrugëve konsiderohet faktor kyç për zhvillimin ekonomik të zonës. Rrugët e komunës kanë bazament të konsoliduar dhe premtojnë investime me cilësi të garantuar. Ndërtimi i një ure lidhëse mbi lumin Drin i Zi do ta bënte komunën e Arrasit vend tranzitor për zonat e Lurës, Reçit e Zall Dardhës. Kjo urë shkurton në mënyrë të ndjeshme distancën për në qytetin e Peshkopisë.

6. Furnizimi me ujë dhe energji elektrike

Nga nëntë fshatra që ka kjo komunë, me ujë të pijshëm nëpërmjet ujësjellësve, furnizohen vetëm fshati Çidhën e Grykë Nokë ose afërsisht 30% e komunitetit. Këto fshatra furnizohen nga linjat e ujësjellësve me gjatësi respektivisht 8100 ml dhe 9200 ml. Është evidentuar mundësia e furnizimit me ujë të një pjese tjetër të komunitetit nëpërmjet vënies në funksionim të pompave me ngritje të ujit në ujësjellësin e ndërtuar në fshatin Çidhën të komunës Arras. Fshatrat Kodër Leshe dhe Arras kanë të ndërtuar sistemin e shpërndarjes dhe pritet vënia në funksionim e ujësjellësit të Saponikës. Problematike paraqitet gjendja e furnizimit me ujë të fshatrave Sinë e Poshtme dhe Sinë e Epërme. Rreth 70% e komunitetit shfrytëzon për ujë të pijshëm burimet e vogla natyrore pranë qendrave të banimit.

Komuna e Arrasit furnizohet me energji elektrike nga n/stacioni i Fushë Çidhnës dhe rrjeti i shpërndarjes së energjisë është funksional. Ekzistojnë në gjendje të mirë pune dhjetë kabina elektrike dhe njëzet transformatorë. Ajo që duhet riparuar është shtimi i orareve të furnizimit me energji elektrike. Kjo justifikuar edhe me nivelin e ulët të humbjeve jo teknike dhe rregullshmërisë së pagimit të energjisë në masën 80% nga banorët. Konsumi mesatar i energjisë elektrike është afërsisht 40 kW/orë për çdo banor/muaj.

7. Transporti dhe telekomunikacioni

Nevojat e komunitetit për transport udhëtarësh, nga fshatrat e komunës në drejtim të Peshkopisë si edhe transporti i nxënësve për në shkolla, realizohet me nëntëmbëdhjetë furgonë, të cilët janë pronë

private e disa personave. Këta të fundit i përdorin furgonët jo rregullisht. Kësisoj, është e vështirë t'i quash biznes i mirëfilltë, pasi gjendja e rrugëve dhe niveli i të ardhurave të banorëve sjell një marzh shumë të ulët fitimi. Kjo edhe për faktin se numri i udhëtarëve është shumë i ulët. Vetëm katër furgonë dhe një minibuz janë regjistruar si biznese transporti deri tani. Transporti i mallrave bëhet me disa mjete-pronë private që aktivizohen në mënyrë sporadike dhe për sasi të vogla.

Telekomunikacioni është në nivel shumë të ulët pasi nuk ka zyrë postare dhe as linja të telefonisë fikse por operohet vetëm me operatorët celularë. Në këto kushte, për internet është e vështirë të flitet. Po ashtu, valët televizive vijjnë vetëm nëpërmjet antenave personale, pasi nuk ka ripetitor që të mundësojë mbulimin e kësaj zone me sinjalet e TVSH-së.

8. Arsimi dhe zhvillimi profesional

Në komunën e Arrasit ka dhjetë shkolla, nga këto një është e mesme e përgjithshme, katër janë 9-vjeçare dhe pesë të ciklit të ulët. Aktualisht numri i nxënësve është tetëqind e pesëdhjetë e nëntë, nga të cilët njëqind e pesëdhjetë e shtatë ndjekin arsimin e mesëm. Rastet e mosfrekuentimit të shkollës janë tridhjetë e tre. Distanca e përshkuar nga nxënësit që frekuentojnë arsimin e mesëm, është relativisht e madhe për t'u përshkuar në këmbë. Arsimin e lartë e frekuentojnë aktualisht njëzet e katër nxënës, tetë prej të cilëve sapo e kanë filluar këtë vit shkollor. Është evidentuar nevoja e trajnimit të personelit mësimdhënës dhe plotësimit të bazës didaktike në shkolla. Është e nevojshme organizimi i një biblioteke letrare dhe shkencore në ambientet e shkollës së mesme, e cila mund t'u shërbejë nxënësve dhe banorëve të tjerë jashtë orarit të zhvillimit të mësimin. Synohet nxitja e arsimit profesional dhe mendohet që 70% e nxënësve që mbarojnë arsimin 9-vjeçar të ndjekin arsimin e mesëm profesional dhe 50% e atyre që mbarojnë arsimin e mesëm të ndjekin arsimin e lartë.

Gjithashtu është evidentuar nevoja për nxitjen dhe organizimin e arsimit parashkollor nëpërmjet iniciativave private, ku dy kopshtet e para mendohet të organizohen në fshatrat Arras e Çidhën. Zhvillimi profesional është i pallogaritshëm, pavarësisht se nevoja për të është e domosdoshme dhe e kërkuar nga banorët, të cilët janë të ndërgjegjshëm për rritjen e domosdoshme të nivelit të tyre profesional për të përballuar sfidat e zhvillimit. Nga ana e komunës po mendohet të planifikohet mundësimi i zhvillimit profesional në fushat më prioritare nëpërmjet ngritjes së një njësie për organizimin e kualifikimeve, duke filluar nga menaxhimi ekonomik i aktiviteteve dhe duke vazhduar me kurse të tjera sipas nevojave të evidentuara. Një objektiv afatshkurtër është vënia në funksionim e kabinetit ekzistues të informatikës pranë shkollës së mesme, i cili mund të shfrytëzohet edhe për kualifikimin e administratës publike dhe banorëve që kanë nevojë për këtë kualifikim.

Konsiderohet si një kërkesë e kohës edhe ngritja e kurseve për gjuhë të huaja.

9. Shëndetësia

Në komunën e Arrasit ekziston një Qendër Shëndetësore funksionale dhe katër ambulanca, aktualisht jofunksionale, me një personel infermier të përbërë nga katërbëdhjetë punonjës dhe një mjek familjeje. Ndihet nevoja për rritjen e kujdesit shëndetësor, si në sasi ashtu edhe në cilësi. Kërkohej pajisja me mjetet e domosdoshme dhe vënia në funksionim e katër ambulancave ekzistuese krahas ndërtimit të katër ambulancave të tjera.

Nevojitet, gjithashtu, trajnimi i personelit për të arritur parametrat mesatarë të shërbimit shëndetësor parësor në drejtim të:

- a) Trajtimin të sëmundjeve infektive
- b) Kujdesit për Nënë dhe Fëmijën
- c) Trajtimin të urgjencave në kushtet e shërbimit shëndetësor parësor
- d) Planifikimin familjar dhe sëmundjeve seksualisht të transmetueshme

Shëndeti i popullatës konsiderohet i mirë dhe shmangia e distrofisë është në qendër të vëmendjes, sepse niveli i dobët ekonomik mund ta favorizojë këtë sëmundje. Aktualisht ka pesëdhjetë të sëmurë kronikë ose dhjetë në një mijë banorë.

Niveli i lindjeve është i ulët dhe me tendencë rënieje edhe pse vdekshmëria foshnjore është gati zero. Rritja natyrale është e vogël, po ashtu edhe ajo mekanike. Konsiderohet problem për t'u zgjidhur sa më shpejt mundësimi i lidhjes së shërbimit parësor në komunë me shërbimin spitalor duke u nisur nga fakti se gjendja e infrastrukturës rrugore është e dobët dhe mungojnë mjetet profesionale të transportit të të sëmurëve.

10. Biznesi

Biznesi përfaqësohet me njësitë tregtare dhe shërbimet, të cilat shkojnë deri në trembëdhjetë të tilla. Biznesi, në kuptimin e mikrofermave nuk është evidentuar, pasi niveli i daljes në treg me prodhime vendase, është shumë i ulët për t'u konsideruar si biznes i mirëfilltë. Evidentohet nevoja për trajnim në menaxhimin e potencialeve bujqësore dhe blegtorale të familjeve në këtë komunë. Gjithashtu, çelja e bizneseve të reja prodhuese, përpunuese apo edhe tregtuese është e lidhur me nivelin e prodhimit dhe të të ardhurave ekonomike. Në komunën e Arrasit janë të regjistruara katër biznese të transportit të mallrave dhe pasagjerëve.

Janë evidentuar dhe janë në proces regjistrimi pesëmbëdhjetë biznese me drejtim tregtar, një prodhues, pesë biznese shërbimesh dhe një biznes grumbullimi bimësh medicinale. Të ardhurat nga taksa vendore e biznesit të vogël për 9-mujorin 2007 arrijnë në 35,000 lekë, nga taksa e përdorimit të tokës 173,000 lekë, nga taksa e ndërtesës janë mbledhur 127,000 lekë, nga regjistrimi i automjeteve 43,000 lekë. Biznesi i prodhimit bujqësor e blegtoral është i paevidentuar ende, pasi sasia e daljes në treg është e vogël dhe shitjet janë sporadike.

Nga një mijë e treqind e shtatëdhjetë e shtatë familje, tregtojnë teprica të prodhimit rreth 60% e tyre. Pritet konsolidimi i bizneseve të lidhura me prodhimet bujqësore të katërqind familjeve dhe të lidhura me prodhimet blegtorale të gjashtëqind familjeve.

Gjithashtu, pritet zhvillimi i bizneseve përpunuese, atyre të grumbullimit dhe përpunimit të bimëve medicinale, prodhimit të mjaltit si edhe bizneseve të lidhura me shërbimet që mungojnë në territorin e komunës. Evidentohet vullneti për organizimin e fermerëve për grumbullimin dhe tregtimin e produkteve të paraplanifikuara.

Iniciativat për zhvillimin profesional dhe menaxhimin ekonomik do të ndihmonin arritjen e objektivave të zhvillimit ekonomik të komunës.

11. Vlerësimi i potencialeve turistike

Afërsia me Bjeshkët dhe zonën e Lurës përbën një potencial të mundshëm për të menduar rreth aktivizimit të turizmit malor familjar, veror e dimëror. Ky potencial është i mundur pas përmirësimit të situatës së rrugëve lidhëse me këto zona. Krijimi i parqeve ku mund të kultivohet faunë e egër, shfaqet si një opsion i mundshëm për t'u realizuar dhe si burim zhvillimi i turizmit .

Gjithashtu, mund të organizohet shfrytëzimi i brigjeve të ulëta të lumit Drin i Zi, si mikroplazhe verore.

IX. Analiza Swot

S-Anët e forta që janë identifikuar si mbështetje për zhvillimin e komunës

PRODHIME BUJQËSORE DHE BLEGTORALE TË TESTUARA EDHE NË TË KALUARËN

Kjo zonë është shquar për prodhime bujqësore dhe blegtorale me rendiment të lartë. Prodhimet e pemëtarisë kanë qenë të shumëllojshme dhe nga kjo zonë janë furnizuar edhe zona të tjera të Shqipërisë dhe duke patur cilësi të mirë edhe janë eksportuar jashtë vendit

VLERAT MJEDISORE

Vlerat mjedisore të zonës vazhdojnë të jenë të larta, pasi pothuajse mungojnë ndotjet e ndryshme aq shqetësuese për shumë zona të tjera. Klima është shumë e përshtatshme për gati të gjithë gamën e prodhimeve bujqësore. Reshjet e shumta, burimet natyrore dhe afërsia me lumin Drin i Zi e Setë si edhe tokat pjellore favorizojnë zhvillimin e bujqësisë e pemëtarisë. Zona është e pasur me pyje e kullota shumë të përshtatshme për zhvillimin e blegtorisë.

TRADITA E PUNËS DHE ARSIMIMIT

Banorët e zonës e kanë traditë brez pas brezi punën dhe kanë kualifikimin e nevojshëm në drejtim të punëve bujqësore dhe blegtorale. Gjithashtu, banorët e zonës njihen historikisht si arsimdashës dhe inteligjentë. Banorët e kësaj zone kanë dhënë prova për iniciimin, realizimin dhe zbatimin e marrëveshjeve me zonat përreth për mbrojtjen e përbashkët të pronave të tyre.

STRUKTURA E ZONËS

Afërsia me Bjeshkët dhe zonat turistike si edhe shumëllojshmëria e florës dhe faunës mund të shfrytëzohen për ndërtimin e parqeve natyrore, ku kultivimi i kafshëve të egra në një ambient shumë të përshtatshëm natyror, mund të tërheqë turistë dhe të apasionuar pas gjuetisë dhe alpinizmit. Aktivitetet e kësaj natyre mund të zhvillohen në të gjitha stinët e vitit.

O-Mundësitë që mund të shfrytëzohen në funksion të zhvillimit

VULLNETI I AUTORITETEVE VENDORE DHE QENDRORE

Identifikohet lehtë angazhimi i autoriteteve të qeverisjes vendore dhe qendrore në iniciativat zhvilluese të komunitetit duke shfaqur një vullnet bashkëpunimi me të gjithë aktorët e mundshëm për arritjen e niveleve më të larta të zhvillimit ekonomik

MUNDËSITË E ZHVILLIMIT TË TURIZMIT

Bashkëpunimi me investitorë vendas dhe të huaj, pa përjashtuar diasporën, si edhe vetitë organizative, promovuese e bashkëpunuese mund të bëjnë të mundur zhvillimin e infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin e turizmit malor, shoqëruar me zhvillimin e sporteve dimërore dhe gjuetisë.

Kjo mundësi potenciale bazohet në strukturën e përshtatshme të relievit, faunës dhe florës së kësaj zone si edhe në tendencën e përmirësimit të infrastrukturës rrugore, furnizimit me ujë dhe energji elektrike dhe komunikimit.

MUNDËSIA E RRITJES SË BIZNESEVE ME PËRDORIMIN E MIKROKREDIVE

Sigurimi i mikrokredive nga institucionet bankare që veprojnë në qendrën e qarkut dhe mbulojnë këtë zonë, po bëhen gjithnjë edhe më të mundshme dhe lehtësisht të realizueshme. Kjo mundësi bazohet edhe në politikat e zhvillimit që kanë qeverisja qendrore dhe vendore, të cilat inkurajojnë bizneset bankare në kreditimin e fermerëve me qëllim mbështetjen e zhvillimit ekonomik të zonave rurale.

RRITJA E SASISË SË PRODHIMEVE TRADICIONALE NGA FERMERËT

Cilësia dhe sasia e tokës, klima dhe sigurimi i ujitjes mund të garantojnë rritjen e prodhimit të të gjitha produkteve bujqësore dhe pemëtarisë tradicionale. Nga eksperiencat e mëparshme mund të themi se prodhimi minimalisht mund të dyfishohet ose trefishohet. Të njëjtën gjë mund të themi për prodhimet blegtorale tradicionale bazuar në kullotat e përshtatshme dhe prodhimit të foragjereve.

MUNDËSIA E PRODHIMEVE TË REJA APO PAK TË ZHVILLUARA NË ZONË.

Eksperiencat e testuara tashmë nga biznese sporadike tregojnë mundësinë potenciale për zhvillimin e prodhimit të troftës, mjaltit cilësor dhe lajthisë. Zhvillimin e prodhimit të këtyre produkteve e garanton edhe cilësia dhe sasia e burimeve ujore, pasuria e faunës dhe florës si edhe sipërfaqet dhe relievi i përshtatshëm për kultivimin e tyre.

APLIKIMI I MODELEVE TË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET FERMERËVE

Një mundësi potenciale për zhvillimin ekonomik të zonës është edhe shfrytëzimi i eksperiencave ndërkombëtare të organizimit të bashkëpunimit në prodhimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve. Kjo mundësi favorizohet edhe nga mundësia e zhvillimit profesional e menaxhues që planifikohet të sigurohet me ndihmën e qeverisjes vendore dhe asaj qendrore.

ZHVILLIMI I BIZNESEVE PËRPUNUESE DHE ATYRE TË GRUMBULLIM-TREGTIMIT

Që tani evidentohet nevoja për ekzistencën e bizneseve përpunuese të produkteve bujqësore dhe blegtorale si edhe aktiviteteve grumbulluese dhe tregtuese. Këto lloj biznesesh paraqiten si nevojë, pasi në këtë mënyrë, shumë produkte jo vetëm mund të përpunohen pranë vendit të prodhimit duke ulur kostot e transportit të cilat janë të larta por edhe garantohet tregu i produkteve. Këto biznese mund

të shërbejnë si nxitëse të prodhimit nga fermerët pasi bëhet i mundur garantimi i shitjes së prodhimit dhe planifikimi .

W-Dobësitë që ngadalësojnë zhvillimin e komunës

SHFRYTËZIMI I ULËT I KAPACITETEVE EKZISTUESE

Dallohet qartë se prodhohet kryesisht për nevoja familjare dhe pak për t'u tregtuar duke mos shfrytëzuar në mënyrën maksimale kapacitetin prodhues të tokës. Kjo nuk ndodh për arsye se fermerët janë pak të interesuar për fitime apo mungon aftësia e tyre. Ka shkaqe objektive, të cilat mund të eliminohen me sigurimin e infrastrukturave normale, mundësimin e kreditimit, mundësimin e organizimeve bashkëkohore dhe garantimin e grumbullimit dhe tregut të shitjes. Ky i fundit nxit shfrytëzimin maksimal të potencialeve prodhuese dhe përpunuese.

ORGANIZIM DHE INICIATIVA TË PAMJAFTUESHME

Vështirësive objektive i shtohet edhe dobësia e shfaqur në organizimin e përpjekjeve të përbashkëta duke shfrytëzuar kapacitetet intelektuale që nuk mungojnë. Kjo vërtetohet edhe me faktin se në mënyrë sporadike individë me iniciativë të lartë dhe aftësi organizimi të biznesit, kanë arritur progres jo të vogël. Kërkohej organizim përpjekjesh dhe bashkëpunim i nxitur dhe përkrahur nga qeverisja vendore e qendrore që të ndërmerren iniciativa të përbashkëta. Ato, deri tani nuk janë të mjaftueshme për të folur për zhvillim ekonomik të konsiderueshëm.

BASHKËRENDIMI I DOBËT I PËRPJEKJEVE

Nuk ekziston klima e përshtatshme e bashkëpunimit për të planifikuar veprime të përbashkëta dhe të ndërvarura. Ndoshta nevojitet ndihmë për të kryer studime konkrete të cilat do ta bënë më të prekshëm rezultatin përfundimtar të bashkëpunimit. Është detyrë e administratës vendore dhe intelektualëve më të përgatitur që të ndërmarrin propozime dhe të zhvillojnë studime për të paraprirë bashkërendimin e përpjekjeve bazuar në platforma të qarta bashkëpunimi.

PRODHOHET KRYESISHT PËR NEVOJA VETIAKE

Për sa kohë do të vazhdojë gjendja që familjet të prodhojnë vetëm për nevoja vetiake, nuk mund të flasim për biznes prodhues me drejtim bujqësor dhe blegtoral. Sasitë e vogla që tregtojnë familjet janë një shpresë e vogël në drejtim të zhvillimit ekonomik të zonës. Kërkohej, që me iniciativa të komunës, të nxitet fillimisht studimi i mundësive që ka çdo familje për të prodhuar me destinacion tregun dhe më pas organizimi për planifikimin e prodhimeve vjetore dhe organizimi për sigurimin e tregut. Shoqatat e biznesit në bazë të produkteve janë një mundësi e mirë për të filluar organizimin e përpjekjeve.

INFRASTRUKTURA JO CILËSORE PËR TË PËRBALLUAR KUSHTET

Mangësitë e infrastrukturave dallohen pjesërisht në infrastrukturën ujëtore dhe kulluese. Infrastruktura rrugore është e dobët dhe konsiderohet si faktori më i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të zonës. Mangësitë në furnizimin me ujë të pijshëm dhe energji elektrike si edhe mundësitë e kushtueshme të komunikimit luajnë rol negativ në zhvillimin ekonomik të zonës. Kërkohej planifikim i përmirësimit hap pas hapi të situatës bazuar në një plan strategjik ku të gjithë aktorët që veprojnë në komunë duhet të gjejnë vetveten me detyra që kërkojnë impenjim dhe bashkëveprim.

T-Kërcënimet dhe shpjegimi i mënyrës së neutralizimit të tyre

MOSARRITJA E PËRMIRËSIMEVE TË DOMOSDOSHME NË INFRASTRUKTURË

Mospërmirësimi i infrastrukturës rrugore dhe furnizimit me ujë e energji në kohë sa më të shpejtë si edhe mosrealizimi i planeve për ujitjen dhe kullimin e tokave, të cilësuar si ndër shkaqet kryesore të frenimit të zhvillimit, do të ndikonte në dekurajimin e fermerëve për të ndërmarrë iniciativa për shtimin e prodhimit dhe shndërrimin e aktiviteteve të tyre në biznese të mirëfillta me fitim të garantuar. Duke qenë se këto përmirësime janë shumë të kushtueshme dhe burimi i financimit mbetet kryesisht qeverisja qendrore dhe donacionet e huaja, rrezikohet mosrealizimi në kohë i këtyre investimeve. Qeverisja vendore, gjithsesi, duhet të bëjë pjesën e saj të punës në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm dhe lobimin për realizimin e tyre bazuar në planin strategjik të zhvillimit.

MOSANGAZHIMI I BANORËVE PËR SHKAK TË NEGLIZHENCËS NË INICIATIVA TË PËRBASHKËTA

Një kërcënim serioz është edhe mosangazhimi i fermerëve në iniciativa të përbashkëta për shkak të mosbesimit ose të moskuptimit të rëndësishëm të tyre. I del për detyrë qeverisjes vendore të ndërmarrë aksione sensibilizuese dhe trajnuese për të arritur mirëkuptimin e fermerëve dhe ngritjen e nivelit menaxhues dhe planifikues të tyre. Iniciativa të tilla duhet të jenë pjesë integrale e planeve strategjike afatshkurta. Gjithashtu, sugjerohet kryerja e studimeve të mirëfillta që do të shërbejnë për krijimin e besimit në realizimin e iniciativave të përbashkëta apo individuale që synojnë zhvillimin e bizneseve të tyre.

THELLIMI I EMIGRIMIT TË BANORËVE TË RINJ DHE TË KUALIFIKUAR

Një rrezik tjetër është migrimi dhe emigrimi i banorëve të kualifikuar, të cilët për arsye ekonomike do të zgjedhin largimin nga zhvillimi i pronave të tyre në komunë. Kjo pjesë e popullsisë është shumë aktive dhe konsiderohet humbje për të gjithë komunitetin. Sugjerohet edhe një herë realizimi i studimeve dhe informimi e trajnimi i banorëve për mundësitë e zhvillimit të bizneseve të tyre me fitim ndoshta disa herë më të madh se të ardhurat që mund të sigurojnë duke migruar apo emigruar.

DEGRADIMI I AMBIENTIT

Kuptohet se duhet marrë në konsideratë edhe kërcënimi i degradimit të tokave bujqësore, pyjeve, kullotave si edhe degradimi i elementeve të zhvillimit të blegtorisë në rast se nuk kushtohet vëmendja e duhur në ruajtjen e mbarështimin e tyre. Kjo gjë evidentohet dhe shumë shpejt duhen marrë masa për frenimin e degradimit me tendencë përmirësimit të tyre. Krijimi i klimës së besimit në suksesin e bizneseve vendase do të krijojë kushtet e duhura krahas investimeve të përqendruara.

MOSANGAZHIMI SA DUHET I QEVERISJES QENDRORE NË PËRMIRËSIMIN E SITUATËS

Një kërcënim që duhet marrë parasysh për t'u eliminuar sa më parë është mosngritja në nivelin e duhur të angazhimit të administratës publike vendore e qendrore, duke u nisur edhe nga fakti i ruajtjes së gjendjes pezull deri sa të marrë drejtimin e duhur çështja e ndërtimit të Hidrocentralit të Skavicës, liqeni i së cilës përmbyt një pjesë të konsiderueshme të sipërfaqeve të disa fshatrave. Studime alternative që parashikojnë skenarë të mundshëm zgjidhjeje janë të domosdoshme për t'u përfshirë në planet strategjike, ku do të jetë e përfshirë edhe shmangia e efekteve sociale me pasoja dëmtuese.

X. Matrica e Planit Strategjik

Në vitin 2015 Komuna e Arrasit do të jetë një nga prodhuesit, përpunuesit e treguesit më të suksesshëm në Qarkun e Dibërës për prodhimet tradicionale bazuar kryesisht në burimet dhe potencialet e komunës				
Synimet	Fusha	Objektivat	Programet	Projektet
Synimi 1: Mëshhtëjta e zhvillimit ekonomik të planifikuar me sisteme infrastrukturalash publike të ndërtuara në nivele që adresojnë nevojat dhe i paraprijnë zhvillimit të veprimitarive private e publike cilësore	Transporti dhe Telekomunikacioni	Objektivi 1.1 Përfshirja e komunës në sistemet e komunikimit kombëtar dhe krijimi në komunë i një sistemi efektiv të transportit	1.1.1 Infrastrukturë komunikimi	1 Projektimi dhe ndërtimi i lidhjes telefonike kablllore me rrjetin kombëtar dhe i shërbimit postar
			1.1.2 Organizim i transportit të automjeteve	2 Vendosja e një antene televizive për mundësimin e shikueshmërisë së kanaleve televizive publike 3 Organizimi i dispeçerisë së transportit me poseduesit e automjeteve në komunë 4 Ngritja dhe mundësimi i transportit me mjete të nxënësve për t'i hapur rrugë përqëndrimit dhe cilësisë 5 Ndërtimi i qendrës komunitare+sistemim-asfaltim i qendrës së komunës 6 Projektim-ndërtimi i rrugës Lazrej-Gur i Zi 7 Projektim-ndërtimi i rrugës Grykë Nokë-Pratë 8 Asfaltimi i rrugëve të brendshme në qendrat urbane të komunës 9 Ndërtimi i rrugëve të brendshme të fshatit Sinë e Poshtme 10 Asfaltimi i rrugës nacionale Muhurr-Arras 11 Asfaltimi i rrugës Zall Sinë-Sinë 12 Asfaltimi i rrugës Arras-Çidhën 13 Asfaltimi i rrugës Çidhën-Grykë Nokë 14 Asfaltimi i rrugës Arras-Mustafë-Gur i Zi 15 Projektim-ndërtimi i urës automobilistike mbi Drinin e Zi që lidh Arrasin me Fushë Çidhnën
	Infrastruktura rrugore	Objektivi 1.2 Ndërtimi i infrastrukturës rrugore në standarde të nevojshme për të plotësuar kërkesat e banorëve dhe biznesit për përshejtim të zhvillimit ekonomik e social në komunë	1.2.1 Infrastrukturë rrugore	16 Ndërtimi i ujësjellësit për fshatin Sinë e Poshtme 17 Ndërtimi i ujësjellësit për fshatin Sinë e Epërme 18 Ndërtimi i ujësjellësit për fshatin Mustafë 19 Ndërtimi i rezervuarit të fshatit Grykë Nokë 20 Përfundimi i ujësjellësit të Soponikës
			1.3.1 Infrastrukturë furnizimi	21 Ndërtimi i sistemit të kanalizimit të ujërave të zeza për fshatin Çidhën
	Furnizim me ujë dhe energji	Objektivi 1.3 Ndërtimi i sistemit të furnizimit me ujë dhe energji elektrike dhe të sistemit të kanalizimeve të ujërave të zeza në nivele që plotësojnë kushtet normale të jetesës në komunë	1.3.2 Infrastrukturë kanalizimesh	

Synimet	Fusha	Objektivat	Programet	Projektet	Nr
Synimi 2: Kthimi i Arrasit në një zonë ku bizneset ruhen, rriten e zhvillohen në sektorët e prodhimit, përpunimit e tregimit të produkteve kryesisht tradicionale dhe ku mundësitë e buqetimit shfrytëzohen në mënyrë racionale për të nxitur shërbime cilësore dhe turizëm	Bujqësia	Objektivi 2.1 Shtimi i sasisë dhe cilësisë së produkteve bujqësore me destinacion tregun e garantuar	2.1.1 Infrastrukturë kanalizimesh për bujqësinë	Rikonstrukcion i sistemit ekzistues vaditës 30 km	22
			2.1.2 Ngritje kapacitetesh	Ndërtimi i pritave mbi lumenjtë Drin dhe Setë Pastrimi i kanaleve kulluese në fshatrat Zall-Sinë, Barnaj, Brraka, Ceka, Mustafe (150 ha) Ofrimi i kurseve të trajnimit për fermerët për çështje të bujqësisë dhe përdorimit të mekanikës bujqësore Ngritja e Shoqatës së Fermerëve me drejtim Bujqësor	23 24 25 26
	Biznesi jobujqësor	Objektivi 2.2 Arrasi do të jetë prodhuesi, përpunuesi e tregtuesi më i suksesshëm, me tregues për frymë mbi mesataren e qarkut të Dibrës, për prodhimet tradicionale të pemëtarisë, blegtorisë, peshkut dhe bimëve mjekësore	2.2.1 Shërbim veterinar	Vaksinimi periodik i gjedhit dhe të imtave sipas normave të studiuara Krijimi i një stacioni për ndërzim artificial	27 28 29
			2.2.2 Nxitje e instalimit të bizneseve	Ndërtimi i baxhos së grumbullimit dhe përpunimit të produkteve blegtorale në Grykë Nokë Hartimi i studimit për rritjen e prodhimit në frutikuturën tradicionale në përputhje me nevojat e tregut	30 31
<p>Përshkrim i shkurtër i projektit: Ky projekt do të mundësojë institucionalizimin e bashkëpunimit të fermerëve me interesa të përbashkëta. Për realizimin e tij do të ndiqen hapat e mëposhtëm: Përgatitja nga ana e komunës, në bashkëpunim me specialistë të fushës, e një materiali informues lidhur me avantazhet që kanë krijimet e shoqatave apo grupeve të fermerëve që kanë interesa të përbashkëta si edhe mënyrën e institucionalizimit të tyre për t'u bërë faktor aktiv në jetën ekonomiko-sociale të komunës e më gjerë. Shpërndarja e informacionit dhe organizimi i mbledhjeve publike me të interesuarit për t'u shpjeguar edhe format e ndihmës që do të sigurojë komuna në drejtim të sigurimit të ambienteve për zhvillimin e mbledhjeve periodike, etj. si edhe sigurimin që zëri i tyre i përbashkët do të merret parasysh në vendimet e autoriteteve vendore. Asistimi në ngritjen dhe legalizimin e këtyre shoqatave me bazë vullnetin e lirë dhe interesin e përbashkët duke i ndihmuar në përgatitjen e statutit dhe formën organizative të funksionimit. Miratimi në Këshillin e Komunës të një fondi për mbështetjen e këtyre shoqatave në fazat e para të veprimtarisë së tyre duke i konsideruar partnerë të ardhshëm.</p>	
<p>Rezultatet e pritshme: Ngritja e nivelit të bashkëpunimit ndërmjet fermerëve me interesa të përbashkëta Sigurimi i premisave për rritjen e pjesëmarrjes së komunitetit në vendimmarrje Ngritja e ekonomisë së bizneseve të fushës Sigurimi i partnerëve të domosdoshëm për qeverisjen vendore</p>	<p>Përfituesit: Administrata e Komunës Komuniteti i biznesit me interesa të përbashkëta</p>
<p>Pjesëmarrësit potencialë: Asistimi në ngritjen dhe legalizimin e shoqatave Miratimi në Këshillin e Komunës</p>	<p>Kontributet potenciale në projekt: Asistimi në ngritjen dhe legalizimin e shoqatave Miratimi në Këshillin e Komunës</p>
<p>Kushte paraprake: Përgatitja e materialeve informuese Përzgjedhja e individëve të besueshëm dhe të aftë për ndihmë Informim me të gjitha mjetet e mundshme të komunitetit</p>	<p>Faktorë të rrezikshëm: Mosrealizimi i informimit të mjaftueshëm për fermerët Neglizhenca e punonjësve të administratës vendore dhe fermerëve Moskrijimi i nivelit të besueshmërisë për rezultatet e pritshme</p>
<p>Shpenzimet e llogaritura: Për materiale informuese Për organizimin e takimeve Për përgatitjen dhe legalizimin e dokumentave</p>	<p>() Lekë () Lekë () Lekë</p> <p style="text-align: right;">TOTALI:</p>
<p>Koha e zbatimit: 2008–2009</p>	<p>Periudha e pritjes së rezultatit: 2009</p>

<p>Emërtimi i Projektit</p> <p>Aplikim i programit ALFA për kontabilitetin në administratën e komunës</p>	<p>Emërtimi i Objektivit:</p> <p>Ngritje e administratës publike në nivele që përputhen me kërkesat e qeverisjes së mirë</p>
<p>Përshkrim i shkurtër i projektit:</p> <p>Ky projekt konsiston në aplikimin e sistemit ALFA të kontabilitetit në administratë me anë të të cilit do të mundësohet dixhitalizimi i të dhënave financiare. Për realizimin e këtij projekti do të ndiqen hapat e mëposhtëm:</p>	
<p>Studimi i tregut për të mundësuar përzgjedhjen e kompanive vendase që kryejnë këtë lloj shërbimi dhe përcaktimi i fondit limit</p> <p>Përcaktimi i posteve të punës ku do të montohet programi, personave që do të trajnohen dhe sistemit i të dhënave ekzistuese financiare</p> <p>Zhvillimi i procedurave të prokurimit për sigurimin e shërbimit të instalimit, trajnimit dhe aplikimit të programit ALFA në rrjetin e administratës së Komunës</p> <p>Instalimi i programit dhe hedhja e të dhënave ekzistuese në bazën e të dhënave me asistencën e kompanisë fituese</p> <p>Trajnimi i punonjësve të administratës që do të përdorin programin dhe dy punonjësve të tjerë jashtë administratës së Komunës</p> <p>Lidhja e kontratës vjetore për mirëmbajtjen e programit</p> <p>Ky program do të mundësojë lehtësimin e procedurave financiare dhe të kontabilitetit, përfshirë bilancin ekonomik të komunës si edhe do të ndihmojë në planifikimin dhe ndjekjen e zbatimit të planit të të ardhurave. Me anë të përdorimit të këtij programi do të mund të prodhohen dokumenta dhe materiale të fushës së financave bashkëkohore në një kohë të shkurtër, të saktë dhe sipas standardeve bashkëkohore.</p>	
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <p>Aftësim i punonjësve të administratës</p> <p>Krijimi i bazës së të dhënave financiare</p> <p>Prodhimi i dokumentave financiare në kohë të shkurtër</p> <p>Cilësi bashkëkohore e dokumentave dhe komunikimi i saktë me institucionet</p>	<p>Përfituesit:</p> <p>Administrata e Komunës</p> <p>Komuniteti</p> <p>Institucionet me të cilat ka lidhje komuna</p>
<p>Pjesëmarrësit potencialë:</p> <p>Autoritetet e Komunës</p> <p>Punonjësit e administratës së fushës së financave</p> <p>Kompania fituese për realizimin e projektit</p>	<p>Kontributet potenciale në projekt:</p> <p>Komuna</p> <p>Donatorë të mundshëm</p>
<p>Kushte paraprake:</p> <p>Studimi i tregut</p> <p>Miratimi i fondeve të mjaftueshme</p> <p>Përzgjedhja e punonjësve që do të trajnohen për të punuar me programin</p> <p>Sigurimi i kompjuterave me parametrat e nevojshëm</p>	<p>Faktorë të rrezikshëm:</p> <p>Mosigurimi i fondeve të mjaftueshme për realizimin e projektit</p> <p>Neglizhenca e punonjësve të administratës vendore</p> <p>Sistemi i të dhënave ekzistuese</p>
<p>Shpenzimet e llogaritura:</p> <p>Për instalimin e programit në dy poste pune dhe lidhja në rrjet () Lekë</p> <p>Për trajnimin në punë e sipër për katër punonjës () Lekë</p> <p>Për kontratën 1-vjeçare të mirëmbajtjes jashtë garancisë () Lekë</p> <p>TOTALI:</p>	
<p>Koha e zbatimit:</p> <p>Gjate vitit 2008</p>	
<p>Periudha e pritjes së rezultatit:</p> <p>Katërmujori i fundit i vitit 2008</p>	

Emërtimi i Projektit	Kodi Q3.01.P1.Pr.48	Emërtimi i Objektivit:
Kompletim i zyrave të komunës me pajisjet e nevojshme		Ngrijte e administratës publike në nivele që përputhen me kërkesat e qeverisjes së mirë
Përshkrim i shkurtër i projektit:		
<p>Nëpërmjet këtij projekti do të realizohet sigurimi i kushteve të përshatshme të punës për punonjësit e administratës. Për realizimin e tij do të ndiqen hapat e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Evidentimi i nevojave për pajisje zyrash për të gjitha zyrat dhe për çdo post pune -Studimi i tregut për të llogaritur fondin e nevojshëm për realizimin e projektit -Analizimi i mundësive financiare dhe sigurimi i fondit të mjaftueshëm -Zhvillimi i procedurave të prokurimit për blerjen dhe montimin e pajisjeve -Montimi i pajisjeve në vendet e parashikuara <p>Gjatë studimit të nevojave do të merret parasysh edhe perspektiva e zhvillimeve të mundshme në komunë për t'i paraprirë nevojave afatshkurta.</p>		
Rezultatet e pritshme:		Përfutjesit:
Krijimi i kushteve të përshatshme për punonjësit e administratës		Administrata e Komunës Komuniteti
Pjesëmarrësit potencialë:		Kontributet potenciale në projekt:
Autoritetet e Komunës Punonjësit e administratës Kompania fituese për realizimin e projektit		Komuna Donatorë të mundshëm
Kushte paraprake:		Faktorë të rrezikshëm:
Studimi i nevojave dhe i tregut për pajisjet e nevojshme Miratimi i fondeve të mjaftueshme		Mosigurimi i fondeve të mjaftueshme për realizimin e projektit Neglizhenca e punonjësve të administratës vendore
Shpenzimet e llogaritura:		
Për pajisje që do të shërbejnë për mobilimin e zyrave Për pajisje elektronike	() Lekë () Lekë	
Koha e zbatimit:	TOTALI:	
Gjatë vitit 2008		Periudha e pritjes së rezultatit:
		Fundi i vitit 2008

Emërtimi i Projektit	Kodi Q3.O1.P2.Pr.49	Emërtimi i Objektivit:
Ngritje pranë komunës e Njësisë së Zhvillimit Profesional		Ngritje e administratës publike në nivele që përputhen me kërkesat e qeverisjes së mirë
Përshkrim i shkurtër i projektit:		
<p>Ky projekt do të mundësojë institucionalizimin e Njësisë së Zhvillimit Profesional.</p> <p>Për realizimin e tij do të ndiqen hapat e mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Në bashkëpunim me drejtuesit e shkollës së mesme arrihet marrëveshja për shfrytëzimin e një ambienti për zhvillimin e kurseve të ndryshme pa çenuar mësimin. -Kryetari i komunës cakton një grup nga administrata, të cilët do të përbëjnë Njësinë e Zhvillimit Profesional. Kjo Njësi do të punojë me kohë të pjesshme dhe do të realizojë evidentimin e kurseve të nevojshme për komunitetin dhe në bashkëpunim me autoritetet e komunës dhe institucionet e tjera do të mundësojë gjetjen e lektorëve për zhvillimin e kurseve -Duke patur parasysh numrin e pjesëmarrësve në këto kurse do të ndërtohet grafiku i zhvillimit të tyre në konsultim edhe me lektorët e përzgjedhur -Grafiku i zhvillimit të kurseve sipas tematikave do të publikohet në vende të dukshme, në çdo fshat dhe në mesin e komunës dhe të shkollës së mesme -Njësia e Zhvillimit Profesional do të arkivojë materialet e përdorura dhe do të përgatisë një raport të shkurtër me të dhëna të nevojshme -Grafiqet e zhvillimit të kurseve do të azhurnohen periodikisht dhe do të miratohen nga Kryetari i Komunës. 		
Rezultatet e pritshme:		Përfutjesit:
Ngritja e nivelit të punonjësve të administratës dhe këshilltarëve		Administrata e Komunës
Arrija e standarteve bashkëkohore të administrimit në të gjitha fushat		Komuniteti
Rritja e nivelit të kënaqshmërisë së komunitetit për shërbimet e ofruara nga komuna		
Pjesëmarrësit potencialë:		Kontributet potenciale në projekt:
Autoritetet e Komunës		Komuna
Punonjësit e administratës		Donatorë të mundshëm, vendas dhe të huaj
ShKSh, Qarku, SNV, etj.		Institucione të qeverisjes qendrore
Kushte paraprake:		Faktorë të rrezikshëm:
Studimi i nevojave dhe mundësi		Mosigurimi i mundësisë për zhvillimin e trajnimeve
Miratimi i fondeve të mjaftueshme		Neglizhenca e punonjësve të administratës vendore
Ndërtimi i grafikut të zhvillimit të trajnimeve		
Shpenzimet e llogaritura:		
Për dieta, akomodim dhe transport	() Lekë	
Për pjesëmarrje në trajnim	() Lekë	
	TOTALI:	
Koha e zbatimit:		Periudha e pritjes së rezultatit:
2008–2010		Pas çdo trajnimi

Emërtimi i Projektit	Kodi Q3.01.P2.Pr.50	Emërtimi i Objektivit: Ngritje e administratës publike në nivele që përputhen me kërkesat e qeverisjes së mirë
Trajnim i punonjësve të administratës dhe këshilltarëve sipas specialiteteve		
Përshkrim i shkurtër i projektit:		
<p>Nëpërmjet këtij projekti do të realizohet trajnimi i këshilltarëve dhe punonjësve të administratës, në mënyrë që t'i përgjigjen kërkesave të kohës. Për realizimin e tij do të ndiqen hapat e mëposhtëm:</p> <p>Evidentimi i nevojave për trajnim në bashkëpunim me Shoqatën e Komunave, Qarkun e Dibrës, SNV etj.</p> <p>Evidentimi i mundësive të ShKSh, Qarkut, SNV etj. për të mundësuar trajnimin sipas tematikave të evidentuara më parë</p> <p>Analizimi i mundësive financiare për sigurimin e trajnimeve të domosdoshme që nuk mund të sigurohen nga institucionet partnere</p> <p>Ndërtimi i grafikut të trajnimeve sipas tematikave dhe planifikimi i pjesëmarrjes</p> <p>Realizimi i trajnimeve dhe arkivimi i materialeve të përdorura gjatë trajnimeve së bashku me raportin përkatës e propozimet e mundshme</p> <p>Gjatë studimit të nevojave do të merret parasysh edhe perspektiva e zhvillimeve të mundshme në komune për t'i paraprirë nevojave afatshkurta.</p>		
Rezultatet e pritshme:		
Ngritja e nivelit të punonjësve të administratës dhe këshilltarëve		
Arritja e standardeve bashkëkohore të administrimit në gjitha fushat		
Rritja e nivelit të kënaqshmërisë së komunitetit për shërbimet e ofruara nga komuna		
Pjesëmarrësit potencialë:		
Autoritetet e Komunës		
Punonjësit e administratës		
ShKSh, Qarku, SNV etj.		
Kushte paraprake:		
Studimi i nevojave dhe mundësive		
Miratimi i fondeve të mjaftueshme		
Ndërtimi i grafikut të zhvillimit të trajnimeve		
Shpenzimet e llogaritura:		
Për dieta, akomodim dhe transport		
Për pjesëmarrje në trajnim		
TOTALI:		
Koha e zbatimit:		Periudha e pritjes së rezultatit:
2008–2010		Pas çdo trajnimi

<p>Emërtimi i Projektit</p> <p>Realizim i bibliotekës letrare dhe shkencore pranë shkollës së mesme</p>	<p>Emërtimi i Objektivit:</p> <p>Arritje e standarteve për zhvillimin e arsimit të detyrueshëm dhe atij të mesëm krahas zhvillimit profesional të popullsisë aktive</p>
<p>Kodi Q3.O2.P1.Pr.62</p> <p>Përshkrim i shkurtër i projektit:</p> <p>Realizimi i këtij projekti do të sigurojë një bazë lehtësisht të prekshme për rritjen e njohurive të nxënësve dhe fermerëve që dëshirojnë të ngrënë nivelin e tyre kulturor apo profesional. Ekzistenca e bibliotekës do të mundësojë azhormimin e të interesuarve me të rejtat e fundit. Biblioteka do të sistemohet me dy pjesë: atë të librit artistik dhe atë profesional. Personeli që do të menaxhojë bibliotekën do të aftësohet për të sugjeruar të rejtat e fundit dhe materialet e domosdoshme për t'u marrë në konsideratë.</p> <p>Sigurimi i ambientit.</p> <p>Kompletimi i ambientit me pajisjet e domosdoshme.</p> <p>Ngritja e një grupi pune për identifikimin e mundësive dhe nevojave që do të ketë biblioteka si fond fillestar librash.</p> <p>Identifikimi i listës së librave që mund të sigurohen nga institucionet pa pagesë.</p> <p>Lidhja e një akt-marrëveshjeje bashkëpunimi me bibliotekën e qytetit të Peshkopisë.</p> <p>Përgatitja e rregullores së funksionimit të bibliotekës duke përfshirë edhe mënyrën e menaxhimit.</p> <p>Përgatitja e preventivit të shpenzimeve dhe aplikimi për sigurimin e fondeve të nevojshme.</p> <p>Realizimi i shpenzimeve nëpërmjet procedurave ligjore.</p> <p>Inagurimi i bibliotekës dhe promovimi i saj.</p>	<p>Përfutjesit:</p> <p>Administrata e Komunës</p> <p>Komuniteti</p> <p>Institucionet me të cilat ka lidhje komuna</p>
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <p>Nxënësit do të kenë mundësi të shfrytëzojnë fondin e bibliotekës</p> <p>Zyrtarët dhe fermerët do të kenë mundësi të shfrytëzojnë fondin e bibliotekës</p> <p>Krijohet një mundësi për kalimin e kohës së lirë në mënyrë të kulturuar</p> <p>Do të rritet niveli i njohurive teknike nga përdoruesit e bibliotekës</p>	<p>Kontributet potenciale në projekt:</p> <p>Komuna</p> <p>Donatorë të mundshëm</p> <p>Institucione të qeverisjes qendrore e vendore</p>
<p>Pjesëmarrësit potencialë:</p> <p>Drejtuuesit e Komunës dhe shkollës së mesme</p> <p>Donatorët e evidentuar</p> <p>Institucionet e qeverisjes qendrore e vendore</p>	<p>Faktorë të rrezikshëm:</p> <p>Mosigurimi i fondeve të mjaftueshme për realizimin e projektit</p> <p>Neglizhenca e punonjësve të administratës vendore dhe shkollës</p>
<p>Kushte paraprake:</p> <p>Studimi i nevojave dhe i mundësive</p> <p>Miratimi i fondeve të mjaftueshme</p> <p>Identifikimi i listës së librave që mund të sigurohen nga institucionet pa pagesë</p> <p>Përgatitja e rregullores së funksionimit dhe mënyrës së menaxhimit</p>	<p>Shpenzimet e llogaritura:</p> <p>() Lekë</p> <p>() Lekë</p> <p>TOTALI:</p>
<p>Koha e zbatimit:</p> <p>Gjatë vitit 2008–2009</p>	<p>Periudha e pritjes së rezultatit:</p> <p>Pas vitit 2009</p>

Emërtimi i Projektit	Kodi Q3.03.P1.Pr.66	Emërtimi i Objektivit:
Trajnim i personelit mjekësor		Përmirësim i shëndetit të popullatës
Përshkrim i shkurtër i projektit:		
<p>Nëpërmjet këtij projekti do të realizohet trajnimi i personelit të shërbimit parësor shëndetësor në mënyrë që t'i përgjigjet kërkesave të kohës. Për realizimin e tij do të ndiqen hapat e mëposhtëm:</p> <p>Evidentimi i nevojave për trajnim në bashkëpunim me institucionet e shërbimit shëndetësor</p> <p>Evidentimi i mundësive të institucioneve të shërbimit shëndetësor për të mundësuar trajnimin sipas tematikave të evidentuara më parë</p> <p>Analizimi i mundësive financiare për sigurimin e trajnimeve të domosdoshme që nuk mund të sigurohen nga institucionet partnere</p> <p>Ndërtimi i grafikut të trajnimeve sipas tematikave dhe planifikimi i pjesëmarrjes</p> <p>Realizimi i trajnimeve dhe arkivimi i materialeve të përdorura gjatë trajnimeve së bashku me raportin përkatës dhe propozimet e mundshme</p> <p>Gjatë studimit të nevojave do të merret parasysh edhe perspektiva e zhvillimeve të mundshme në komunë për t'i paraprirë nevojave afatshkurta</p>		
Rezultatet e pritshme:		Përfutjesit:
Ngrija e nivelit të punonjësve të shërbimit shëndetësor parësor		Personeli i shërbimit shëndetësor parësor në komunë
Arrija e standarteve bashkëkohore të shërbimit shëndetësor		Komuniteti
Rritja e nivelit të kënaqshmërisë së komunitetit për shërbimet e ofruara		
Pjesëmarrësit potencialë:		Kontributet potenciale në projekt:
Drejtuesit e Qendrës Shëndetësore në komunë		Institucionet e shërbimit shëndetësor
Institucionet e shërbimit shëndetësor		Drejtuesit e Qendrës Shëndetësore në komunë
Kushte paraprake:		Faktorë të rrezikshëm:
Studimi i nevojave dhe mundësive		Mosigurimi i mundësisë për zhvillimin e trajnimeve
Miratimi i fondeve të mjaftueshme		Neglizhenca e punonjësve të shërbimit shëndetësor
Ndërtimi i grafikut të zhvillimit të trajnimeve		
Shpenzimet e llogaritura:		
Për dieta, akomodim dhe transport	() Lekë	
Për pjesëmarrje në trajnim	() Lekë	
	TOTALI:	
Koha e zbatimit:		Periudha e pritjes së rezultatit:
2008–2010		Pas çdo trajnimi

Emërtimi i Projektit	Kodi Q3.O3.P2.Pr.70	Emërtimi i Objektivit:
Pajisje e Qendrës Shëndetësore me një autoambulancë		Përmirësim i shëndetit të popullatës
Përshkrim i shkurtër i projektit:		
<p>Nëpërmjet këtij projekti do të realizohet sigurimi i një autoambulance e cila do të zgjidhë problemin e lidhjes së shërbimit parësor me atë spitalor dhe ngrijen e nivelit të shërbimit të urgjencës kur mundësitë e Qendrës Shëndetësore nuk mjaftojnë.</p> <p>Për realizimin e tij do të ndiqen hapat e mëposhtëm:</p> <p>Studimi i tregut për të llogaritur fondin e nevojshëm për blerjen e autoambulancës sipas parametrave të paracaktuara</p> <p>Analizimi i mundësive financiare dhe sigurimi i fondit të mjaftueshëm për blerjen e autoambulancës, pagën e shoferit, karburantin dhe shërbimin periodik</p> <p>Zhvillimi i procedurave të prokurimit për blerjen e autoambulancës</p> <p>Përzgjedhja e shoferit</p> <p>Montimi i pajisjeve në vendet e parashikuara</p> <p>Ndërtimi i grafikut të punës për vënien në efëncë të autoambulancës</p> <p>Do të shihet mundësia e bashkëpunimit edhe me komunat e afërta për kombinimin e kontributit dhe të shërbimit.</p>		
Rezultatet e pritshme:		Përfituesit:
Rritja e nivelit të shërbimit të urgjencës		Komuniteti
Rritja e nivelit të kënaqshmërisë së komunitetit		Të sëmurët kronikë
Realizimi i bashkëpunimit më efektiv me instituc. e tjera të shërb. shëndetësor		Personeli shëndetësor
		Autoritetet e Komunës
Pjesëmarrësit potencialë:		Kontributet potenciale në projekt:
Autoritetet e Komunës		Komuna
Institucionet qendrore të shëndetësisë		Donatorë të mundshëm
Personeli i Qendrës Shëndetësore		Institucionet qendrore të shëndetësisë
Kushte paraprake:		Faktorë të rrezikshëm:
Studimi i tregut për një autoambulancë me parametra që i përgjigjen nevojës		Mosigurimi i fondeve të mjaftueshme për realizimin e projektit
Miratimi i fondeve të mjaftueshme		Neglizhenca e administratës vendore dhe qendrës shëndetësore
Shpenzimet e llogaritura:		
Për blerjen e autoambulancës	() Lekë	
Për fond page, karburant, shërbime (për një vit)	() Lekë	
	TOTALI:	
Koha e zbatimit:		Periudha e pritjes së rezultatit:
Gjatë vitit 2008		Fundi i vitit 2008

Emërtimi i Projektit	Kodi Q3.03.P2.Pr.71	Emërtimi i Objektivit:
Pajisje e ambulancave me frigoriferë për ruajtjen e vaksinave		Përmirësim i shëndetit të popullatës
Përshkrim i shkurtër i projektit:		
Ky projekt konsiston në pajisjen e Qendrës Shëndetësore dhe ambulancave të çdo fshati me frigoriferë për ruajtjen e vaksinave. Për realizimin e tij do të ndiqen hapat e mëposhtëm: Studimi i tregut për të llogaritur fondin e nevojshëm për blerjen e frigoriferëve sipas parametrave të paracaktuara Analizimi i mundësive financiare dhe sigurimi i fondit të mjaftueshëm për blerjen e frigoriferëve Zhvillimi i procedurave të prokurimit për blerjen e frigoriferëve Montimi i frigoriferëve në vendet e parashikuara		
Rezultatet e pritshme:		Përfituesit:
Sigurimi i efektshmërisë së vaksinave Rritja e nivelit të kënaqshmërisë së komunitetit Mundësimi i planifikimit kohor për realizimin e vaksinimeve		Komuniteti Personeli shëndetësor Autoritetet e Komunës
Pjesëmarrësit potencialë:		Kontributet potenciale në projekt:
Autoritetet e Komunës Instrukcionet qendrore të shëndetësisë Personeli i Qendrës Shëndetësore		Komuna Donatorë të mundshëm Instrukcionet qendrore të shëndetësisë
Kushte paraprake:		Faktorë të rrezikshëm:
Studimi i tregut për frigoriferë me parametra që i përgjigjen nevojës Miratimi i fondeve të mjaftueshme		Mosigurimi i fondeve të mjaftueshme për realizimin e projektit Neglizhenca e administratës vendore dhe Qendrës Shëndetësore
Shpenzimet e llogaritura:		
Për blerjen e 10 frigoriferëve Për shpenzime transporti, montimi dhe përshtatje		() Lekë () Lekë
	TOTALI:	
Koha e zbatimit: Gjatë vitit 2008		Periudha e pritjes së rezultatit: Fundi i vitit 2008

Shtojca 1: Vendimi i Këshillit Komunal për miratimin e PSZhEV

REPULIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I KOMUNES ARRAS

VENDIM

Nr 1 date 23.01 2008

PER
MIRATIMIN E STRATEGJISE AFATMESME TE ZHVILLIMIT
2008-2015 TE KOMUNES ARRAS, DIBER.


Keshilli i komunes ne mbledhjen e tij te dates 23.01 2008 pasi u njoh me materialin e paraqitur per strategjine afatmesme te zhvillimit 2008-2015 te komunes Arras,

vendosi:

Miratimin e strategjise afatmesme te zhvillimit 2008-2015 te komunes Arras.

Ky vendim hyne ne fuqi 10 dite pas shpalljes se tij.

KRYETARI I KESHILLIT
XHE TAN LESH



Shtojca 2: Analiza e anketimit me biznesin vendor

Të dhëna të përgjithshme

Modele (P. 1) Njëzet e pesë sipërmarrje u anketuan dhe u mblodhën opinione nga të intervistuarit që vijojnë: pronar, njëzet e katër sipërmarrje (96%), duke përfshirë Drejtorin e Përgjithshëm dhe administratorin e marketingut të të paktën një sipërmarrjeje dhe administratori financiar dhe i marketingut, një sipërmarrje (4%).

Lloji i sipërmarrjes (P. 2) Shumica e sipërmarrjeve (68%) ishin bujq. Dhjetë (40%) rrisnin bagëti, duke përfshirë një që merrej edhe me tregti, shtatë (28%) rritnin vetëm drithë, katër (16%) merreshin me prodhim, duke përfshirë një që ishte edhe tregtar dhe katër të tjerë (16%) ishin tregtarë, duke përfshirë një që ofronte edhe shërbime.

Pronësia (P. 3) Shumica e sipërmarrjeve (80%) kishin vetëm një pronar, ndërsa katër (16%) zotëroheshin bashkërisht dhe një ishte kooperativë.

Lloji i prodhimeve (P. 4) Shtatë sipërmarrje (28%) prodhonin qumësht dhe shumica si produkt parësor, të ndjekur nga mishi (vini re të kundërtën me Fushë Çidhnën dhe Zall Dardhën, që renditnin mishin para qumështit). Pesë prej tyre prodhonin edhe lesh. Katër ferma (16%) merreshin me prodhim frutash, duke përfshirë një që prodhonte edhe drithëra dhe një që prodhonte edhe miell dhe rriste bagëti. Dy sipërmarrje kishin veprimtari parësore si tregtia, prodhimi i drithërave, prodhimi i mishit, kalema për bujqësi dhe pemë dhe secila shënoi edhe ‘peshkim’, ‘drithë, mjaltë dhe fruta’, ‘mbledhje bimësh mjekësore’, ‘miell’ dhe ‘ushqime dhe miell’.

Kohëzgjatja e veprimit (P. 5) Kohëzgjatja e sipërmarrjeve varioje nga dy në pesëmbëdhjetë vjet, me një mesatare prej vetëm pak më pak se shtatë vjetësh.

Tregu (P. 6) 20% e sipërmarrjeve e shisnin 100% të produktit të vet në vend, ndërsa të tjerë jepnin një shifër që varioje nga 20% në 90%. Tetë sipërmarrje (32%) e shisnin të gjithë prodhimin e tyre brenda rajonit. Katër sipërmarrje (16%) shisnin nga 20% në 80% të prodhimit të tyre gjetiu brenda vendit por jo për eksport.

Numri i të punësuarve (P. 7) Njëzet e dy (88%) sipërmarrje kishin pesë ose më pak të punësuar (tetë prej tyre kishin vetëm një të punësuar dhe katër nuk kishin asnjë) dhe një kishte nga njëmbëdhjetë në pesëdhjetë të punësuar.

Pamje të mjedisit të sipërmarrjes

Zgjerimi i veprimtarisë (P. 8) Nëntëmbëdhjetë sipërmarrje (76%) raportuan që ata do t'a zgjeronin veprimtarinë e tyre brenda komunës dhe dy (8%) jashtë komunës. Dy raportuan thjesht se do të zgjeronin veprimtarinë e tyre, ndërsa dy (8%) thanë se nuk planifikonin t'a bënin. Askush nuk kishte në plan të eksportonte prodhimet jashtë vendit.

Vështirësi në gjetjen e stafit të trajnuar (P. 9) Shumica e të anketuarve (76%) thanë se nuk kishin vështirësi në gjetjen e stafit të kualifikuar.

Fushat e trajnimit të stafit (P. 10) Me përjashtim të faktit që shumica e sipërmarrjeve nuk kishin vështirësi në gjetjen e stafit të trajnuar (P. 9), shumica (52%) çmonin që sipërmarrja e tyre do të përfitonte nga trajnimi në aftësi teknike. Një numër më i vogël (pra, shumica e linte përgjigjen të bardhë) kërkonin trajnim në Marketing dhe Shitje (36%), Përdorim Kompjuteri (24%), Administrim dhe Kontroll Cilësie (secila nga 20%), Financë dhe Buxhetim (secila nga 12%). Një i anketuar iu përgjigj pyetjeve si vijon: Marketing dhe Shitje, Administrim, Buxhetim, Kontroll Cilësie, Financë, Përdorim Kompjuteri dhe Aftësi Teknike. Një tjetër i renditi si vijon: Aftësi teknike, Administrim, Financë, Përdorim kompjuteri, Marketing dhe Shitje, Kontroll Cilësie dhe Buxhetim, dhe njëri i vendosi Aftësitë Teknike mbi trajnimin për Administrim.

Burimi kryesor i konkurrencës (P. 11) Njëzet e dy sipërmarrje (88%) raportuan që hasnin njëfarë konkurrence: nga konkurrenca e pandershme (48%), duke përfshirë tregun e zi, importet (36%) dhe një nga 'mungesa e ujitjes'.

Përfitimet e shoqatës së sipërmarrjes (P. 12) Shumica e të anketuarve (92%) çmonin që shoqatat e sipërmarrjes mund të ndihmonin zhvillimin lokal të sipërmarrjes, ku asnjëri nuk shprehej që nuk do të mundeshin.

Emërtimi i shoqatave të sipërmarrjes (P. 13) Gjashtë të anketuar (24%) thanë një shoqatë biznesi, duke përfshirë Trojasin, Seta-n dhe Ostushin (12%), dy shënuan Trofta dhe një Shoqatën e Ujitjes dhe Pylltarisë, dhe të Bujqve. Dymbëdhjetë të anketuar (48%) thanë 'asnjë', dy nuk e dinin dhe dy nuk iu përgjigjën pyetjes.

Investime të ardhshme (P. 14) Shumica e të anketuarve (92%) u përgjigjën që do të bënin investime të ardhshme. 36% shënuan blegtorinë (duke përfshirë 16% që specifikonin përmirësimin gjenetik të bagëtisë), 20% që specifikonin bujqësinë (një nga këta specifikoi edhe frutat, dhe një kultivimin e bimëve më të kërkuara), 20% të tjerë specifikuan rritjen e frutave (dy nga të cilët shënuan edhe bagëtinë si fushë e dytë), dhe dy (8%) shënuan tregtinë. Dy të anketuar nuk do të bënin investime të ardhshme, një për shkak të rrugëve të këqija.

Faktorë që pengojnë zgjerimin e sipërmarrjes (P. 15) Të gjithë të anketuarit dhanë arsye për parandalimin e zgjerimit të sipërmarrjes së tyre. Çështje madhore ishte infrastruktura (68%), që përfshin rrugë të varfra (44%) dhe mungesën e sipërfaqes (4%). Çështje të tjera të përmendura ishin mungesa e tregut dhe fondeve (secili nga 12%), konkurrenca e paligjshme dhe niveli i ulët ekonomik, secili i shënuar nga një i anketuar.

Kishte një seri të larmishme me arsye dytësore kryesore që parandalojnë zgjerimin e sipërmarrjes, duke përfshirë mungesën e pajisjeve përpunuese (16%), prodhimtarinë e ulët dhe nivelin e ulët ekonomik të bashkësisë (secili nga 12%), dhe infrastrukturën e dobët (8%) dhe një i anketuar që përmendte largësinë nga tregu, mungesën e rrugëve dhe urave drejt qytetit, të kontratave të shitjes, farërave, ujitjes, tregut dhe kredive nga bankat, me hua me interesa të larta, konkurrencën e pandershme dhe çmimet e larta.

Shumica e arsyeve të treta kryesore të dhëna ishin financiare, duke përfshirë fuqinë e ulët blerëse, mungesën e tregut (16% secila) dhe mungesën e financimit (12%), të ndjekura nga infrastruktura (12%), niveli i ulët ekonomik i bashkësisë, mungesa e garancive nga shteti dhe konkurrenca e pandershme (8% secili). Mungesa e pajisjeve dhe vaditjes, niveli i ulët i mbjelljes së kalemave dhe nivelet e larta të interesave u përmendën secila nga një i anketuar.

Shumica e të anketuarve (84%) treguan një çështje të katërt kryesore që përfshinte bagëti jocalësore (12%), konkurrencë të pandershme, fuqi të ulët blerëse, kosto të larta të plehrave kimike, mungesë tregu, infrastrukturë të keqe dhe reshje dëbore (secila nga 8%), të ndjekura nga mungesa e fondeve, uji i pijshëm, farërat dhe fuqia punëtore, rrugët e këqija dhe largësia e madhe nga zonat qytetëse.

Thuajse gjysma e të anketuarve shënuan një çështje të pestë që përmbliidhte mungesën e furnizimit me ushqim dhe largësinë e madhe nga zonat qytetëse (secila nga 12%), mungesën e elektricitetit, herbicideve, turizmin malor dhe familjar, njohjen e potencialeve turistike dhe sipërfaqet e mbjella, çmimet e larta të plehrave kimike dhe farërave, infrastrukturën e dobët dhe terrenin e vështirë.

Vlerësimi i institucioneve vendore

Koha e harxhuar për marrjen e lejes apo licencës (P. 16) Shumica e të anketuarve u përgjigj se për të marrë leje duhet një periudhë nga 1 deri në 30 ditë dhe me një mesatare të të anketuarve për 10 ditë.

Çështje specifike që ndikojnë/prekin biznesin (P. 17) Dy problemet **më të mëdha** që biznesi ka me qeverinë vendore është ekonomia joformale dhe kostot e larta (përkatësisht 40% dhe 36%, thonë që ka një ndikim të madh), pasuar nga konkurrenca e pandershme, koha e humbur dhe korrupsioni (secila nga 16%). 12% e bizneseve kanë një ndikim tepër të madh nga ndryshimet e shpeshta në rregullore, kërkesa të paparashikuara dhe të mbivendosura dhe për 8% vetëm rregullat tepër komplekse.

Çështje me ndikim në shumë biznese janë ndryshimet e shpeshta në rregullore (44%), korrupsioni (40%), kostot e larta (32%), kërkesat e paparashikueshme (28%), rregullat shumë komplekse dhe humbjet e kohës (secila nga 24%), rregullat e mbivendosura (20%), konkurrenca e pandershme (16%) dhe ekonomia joformale (12%).

Çështjet për të cilat sipërmarrjet thanë që nuk kanë ndikim në punën e tyre ishin koha e humbur (60%), rregullat tepër komplekse, kërkesat e paparashikuara dhe konkurrenca jo e ndershme (secila 52%), rregullat

që mbivendosen (48%), ndryshimet e shpeshta në rregullore (44%), korrupsioni (36%), ekonomia joformale (32%) dhe kostoja e lartë (24%).

Si mund ta ndihmojë komuna biznesin (P. 18) Fusha kryesore në të cilën shumica e bizneseve (60%) mendon se komuna mund të ndihmojë është përmirësimi i infrastrukturës. Tre të anketuar të tjerë zgjedhën këtë fushë por pa e kategorizuar atë përkundrejt zgjedhjeve të tjera. Katër të anketuar (16%) zgjedhën përmirësimin e politikave të taksave dhe dy të tjerë vendosën ofrimin e trajnimeve.

Infrastruktura dhe politika e taksave u renditën të dytat mes 20% të bizneseve, trajnimi dhe sigurimi i informacionit u renditën secila më pas me nga 12%, ndërkohë që vetëm një zgjedhi procedurat.

Informimi, procedurat, politika e taksave dhe trajnimi e infrastruktura u renditën të tretat me përkatësisht 20, 16, 12, dhe 4 % të të anketuarve.

Procedurat u renditën të katërtat ndërmjet 20% të anketuarve, pasuar nga trajnimet (8%). Informimi dhe politika e taksave u zgjedhën nga një i anketuar.

Tre fusha u përzgjedhën të pestat: Trajnimi (24%), politika e taksave (8%) dhe informimi nga një i anketuar.

Katër të anketuar (16%) zgjedhën tjetër, përfshirë dy që specifikuan “punë me fondacionet për të ndihmuar fermerët në biznes”.

Sa shpesh janë inspektuar nga autoritetet (P. 19) Një (i pavizituar) i anketuar mendonte që inspektimet nga autoritetet nuk janë të aplikueshme.

Dy (8%) nga sipërmarrësit janë inspektuar, njëri në dy raste, për inspektim llogarish në vitin e mëparshëm nga drejtoria lokale e Tatim-Taksave. Një gjobë (5,000 dhe 87,000 lekë) u pagua nga secili biznes. Nëntë nga dhjetë të anketuar që iu përgjigjën, mendonin që një inspektim i tillë ishte i arsyeshëm.

Njëmbëdhjetë sipërmarrje (44%) janë inspektuar, njëra në dy raste në vitin e mëparshëm nga Inspektoriati Sanitar. Dy të anketuar dhanë si arsye cilësinë. Vetëm dy nga të anketuarit menduan që këto inspektime ishin të arsyeshme, dhe tre, shtuar të anketuarin e painspektuar si inspektime të paarsyeshme.

Trembëdhjetë sipërmarrje (52%) ishin inspektuar të paktën një herë (pesë prej tyre dy herë, dhe një tetë herë) vitin e mëparshëm nga zyrtarët e komunës. Një i anketuar shënoi si arsye ‘për të ofruar’. Shtatë të anketuar, përfshirë pesë që ishin inspektuar (përfshirë dhe atë të vizituar tetë herë) thanë se ishin vizita të arsyeshme. Dy të anketuar thanë që vizitat ishin të arsyeshme. Dy të anketuar thanë që vizitat nuk aplikohen.

Dy sipërmarrje ishin inspektuar (një herë) nga autoriteti liçensues, dhe njëri kishte paguar një gjobë prej 5 000 lekë. Katër të anketuar mendojnë që inspektime të tilla janë të arsyeshme.

Një i anketuar ishte inspektuar të paktën një herë nga autoriteti mjedisor. Tre të anketuar mendojnë që inspektime të tilla janë të paarsyeshme dhe dy mendojnë se janë të arsyeshme.

Dymbëdhjetë të anketuar (48%) janë vizituar nga policia bashkiake (për siguri), katër prej tyre në tre raste. Nëntë prej tyre mendojnë që inspektime të tilla ishin të arsyeshme.

Asnjë biznes nuk ka patur vizita nga zyrtarë të tjerë.

Faktorë që mbështesin efikasitetin në administrim (P. 20; shih Tabelën 1) Çështje të para si tepër problematike për administrimin efikas të sipërmarrjeve janë rrugët (nga 92% e të anketuarve), furnizimi me ujë (72%), elektriciteti (60%), shërbimet efikase në mbështetje të sipërmarrjeve (40%) dhe në një shtirje më të vogël, korrupsioni (36%). Çështjet e tjera u panë si problematike nga 32% e sipërmarrësve apo më pak, dhe mbrojtja e forcave të rendit e krimi u lanë të pazgjedhura.

Tabela 1. Pyetja 20: Ju lutem vlerësoni secilin nga faktorët për rolin mbështetës që ato luajnë në rritjen e efikasitetit të administrimit të biznesit tuaj

Faktorët që ndihmojnë biznesin	Asnjë problem	Problem i vogël	Problem i madh	Nuk aplikohet
Cilësia e rrugëve		2	23	
Lejet dhe liçencat për ushtrim aktiviteti	8	8	2	
Furnizimi me energji elektrike		8	15	
Furnizimi me ujë	1	1	18	
Mjedisi ku biznesi është aktiv / toka	13	3	3	
Mbrojtja nga policia	16	2		1
Mbrojtja nga zjarri	6	4	6	1
Planifikimi urban dhe zonimi	6	4	4	1
Nivelet e taksave	9	3	5	
Spitalet dhe kujdesi shëndetësor	4	5	8	
Sistemi i arsimit	1	6	7	
Kosto për telekomunikacion	7	1	3	4
Krimi, vjedhjet dhe mungesa e rendit	12	1		4
Cilësia e pushtetit vendor	16		1	
Kosto banimi	5	10	3	
Mungesa e personelit të kualifikuar	2	11	3	
Korrupsioni	6	1	9	3
Akses dhe kosto për burimet financiare	1	8	8	
Shërbime efikase në mbështetje të bizneseve	4	4	10	

Në të vërtetë, mbrojtja nga forcat e rendit dhe krimi u panë si problemet më të vogla, nuk ishin parë fare si problem përkatësisht nga 64% dhe 48% e të anketuarve. Gjithashtu cilësia e pushtetit vendor nuk është parë si problem për 64% të të anketuarve, po ashtu edhe niveli i taksave nga 36% e të anketuarve.

Çështjet që shihen si disi problematike përfshijnë mungesën e personelit të kualifikuar (44%) dhe kostot e banimit (40%). Çështjet e tjera u panë si problematike nga 32% apo më pak e të anketuarve. Planifikimi urban dhe arsimit nuk ishin zgjedhur respektivisht nga 40% dhe 44% e të anketuarve.

Niveli i mbështetjes për SME-t vendore (P. 21) Ka një diapazon të gjerë në pikëpamjet mbi nivelin e sigurimit të mbështetjes për SME-të në komunë.

Shoqatat e biznesit: jo shumë të mirë 20%; kënaqshëm 4%; mirë 12%; shumë mirë 8%; nuk e di 4%; jo relevante 20%; pa përgjigje 32%.

Shoqatat profesionale: jo shumë të mirë 24%; kënaqshëm 4%; mirë 8%; shumë mirë 4%; nuk e di 4%; jo relevante 20%; pa përgjigje 36%.

Qeveria vendore: jo shumë të mirë 0%; kënaqshëm 32%; mirë 4%; shumë mirë 48%; nuk e di 0%; jo relevante 0%; pa përgjigje 12%.

Shërbimet: jo shumë të mirë 12%; kënaqshëm 20%; mirë 24%; shumë mirë 16%; nuk e di 8%; jo relevante 0%; pa përgjigje 20%.

Zyra rajonale e zhvillimit ekonomik: jo shumë të mirë 16%; kënaqshëm 4%; mirë 4%; shumë mirë 4%; nuk e di 8%; jo relevante 4%; pa përgjigje 60%.

Organizatat ndërkombëtare: jo shumë të mirë 8%; kënaqshëm 0%; mirë 0%; shumë mirë 4%; nuk e di 12%; jo relevante 12%; pa përgjigje 64%.

OJF-të: jo shumë të mirë 0%; kënaqshëm 12%; mirë 12%; shumë mirë 4%; nuk e di 36%; jo relevante 16%; pa përgjigje 20%.

Niveli i bashkëpunimit me institucionet vendore (P. 22) Zyra e Kryetarit, Këshillit të Komunës dhe zyra e taksave të komunës janë cilësuar si shumë ndihmëse nga përkatësisht 76%, 72% dhe 68% e të anketuarve. Këto zyra janë cilësuar nga të tjerët si mbështetëse (përkatësisht 20%, 12% dhe 16%). Zyra e Prefektit është parë nga 52% si mbështetëse (28% nuk e dinë), ndërsa zyra e taksave të qarkut është parë jo mbështetëse nga 44% e të anketuarve, 8% e cilësojnë mbështetëse dhe 12% si tepër mbështetëse (20% nuk i janë përgjigjur). Kishte një sërë pikëpamjesh mbi zyrën rajonale të zhvillimit ekonomik, 32% e shohin mbështetëse, 8% si shumë mbështetëse, 12% jo mbështetëse, 20% nuk dinë gjë, 8% e shohin jo relevante dhe 20% e lanë pa përgjigje.

Zyra vendore në mbështetje të sipërmarrjes (P. 23) Pothuaj një e treta e të anketuarve (32%) nuk dinin gjë për ndonjë zyrë që t'i kishte ndihmuar sipërmarrjet e tyre. Gjithsesi, 28% përmendën Zyrën e Shërbimeve, 12% përmendën Shërbimin Veterinar dhe Zyrën e Bujqësisë, dy të anketuar përmendën Zyrën e Financës (duke përfshirë njërin që kishte specifikuar tashmë Bujqësinë), dy të tjerë shënuan 'asnjë', ndërsa një përmendi zyrën e Kryetarit.

Zyra vendore që nuk mbështet sipërmarrjen (P. 24) Vetëm pak më shumë se gjysma e të anketuarve (52%) nuk dinin për ndonjë zyrë që të kishte ndikuar negativisht tek sipërmarrjet e tyre, dy të anketuar shënuan 'të gjithë', pesë (20%) shënuan 'asnjë', dhe një shënoi 'Investim'.

Zyra vendore që merret me Zhvillimin Ekonomik Vendor (P. 25) Shumë të anketuar (40%) thanë që nuk dinin për ndonjë zyrë të komunës që të merrej me zhvillimin ekonomik vendor, dy të anketuar shënuan 'asnjë'. Thuajse një e treta (32%) shënuan 'investime', dy "asistencën sociale" dhe nga një për "Zyrën e Kryetarit" dhe "Zyrën e Financës dhe Taksave".

Grupi më veprimtar në nxitjen e Zhvillimit Ekonomik Vendor (P. 26) 76% e të anketuarve mendonin që qeveria e komunës ishte shumë aktive në nxitjen e ZhEV, një mendonte për organizimin e një partneriteti privat-publik, ndërsa dy të anketuar nuk e dinin dhe tre e lanë pa përgjigje. Nga njëzet që shënuan një organizatë, gjashtëmbëdhjetë (pra 80%) mendonin që Komuna nuk kishte financuar as pjesërisht atë organizim (duke përfshirë katërmbëdhjetë që kishin shënuar ‘Komuna’), ndërsa tre mendonin që i jepte mbështetje financiare vetes.

Grupi që merret me ZhEV në komunë (P. 27) Më shumë se dy të tretat e të anketuarve (68%) mendonin që zyra e Kryetarit merret me çështjet e ZhEV, ndërsa 24 % specifikuan që nuk e dinin.

Vështrim për zhvillimin ekonomik

Tre sektorët me rritjen më të shpejtë në komunë (P. 28) Pothuaj gjysma e të anketuarve (40%) shënuan bujqësinë si sektorin me rritje më të shpejtë në komunë, i ndjekur nga blegtoria (28%). 16% specifikuan frutikulturën dhe nga një për bimët mjekësore dhe peshkim.

48% shënuan blegtorinë si sektorin e dytë më të shpejtë për rritje, 20% shënuan bujqësinë dhe 16% frutikulturën.

Tridhjetë e dy shënuan frutikulturën si sektorin me rritje më të shpejtë, të ndjekur nga ushqimi për bagëti dhe bletaria (secila nga 12%). Blegtoria, bujqësia, vreshtaria, komunikimet, hidroenergija dhe elektriciteti u shenjuan secila nga një i anketuar.

Tre sektorët me rënien më të shpejtë në komunë (P. 29) Thuajse një e treta e të anketuarve (32%) shenjuan prodhimin e miellit ose të drithërave si sektorin që përjetonte rënien më të shpejtë në komunë, të ndjekura nga infrastruktura ose superstruktura (16%), ndërtimi ose bujqësia (secila nga 12%) dhe bimët mjekësore (8%). Nga një secili shënoi bletarinë, nivelin e ekonomisë dhe terrenin dhe njëri specifikoi ‘çdo gjë po shkon poshtë’.

Ndërtimi shihej nga thuajse gjysma e të anketuarve (40%) si sektori i dytë për nga rënia, i ndjekur nga ushqimi për bagëti (8%). Një i anketuar shënoi prodhim drithërash, bagëti, ekonomi, bletari, infrastrukturë, përpunim qumështi, përpunim prodhimesh dhe pulari.

Thuajse një e treta e të anketuarve (32%) mendonin që përpunimi i prodhimeve ishte sektori i tretë më në rënie, i ndjekur nga tregu ose tregtia (12%) dhe pemëtaria (8%). Secili i anketuar shënoi nivelin ekonomik, ndërtimin, bletarinë, vreshtarinë dhe infrastrukturën.

Tre aspektet më tërheqëse të zhvillimit të sipërmarrjes në komunë (P. 30) Shumica shpesh shenjuan si anë më tërheqëse për zhvillimin e sipërmarrjes forcën e punës (40%), duke përfshirë si të lirën dhe atë të kualifikuar, të ndjekur nga interesi ose pasioni i komunitetit për zhvillim (20%), klima, topologjia, pemëtaria dhe vreshtaria (secila nga 8%). Secili i anketuar shënoi qetësinë dhe sigurinë në vend, përvojën në mbledhjen e bimëve mjekësore dhe kulturën e njerëzve.

Aspektet e dyta më tërheqëse ishin forca e punës (24% secili), klima dhe pasioni i njerëzve (secili nga 16%), bukuria natyrore (12%) dhe bujqësia (8%). Aspekte të tjera që u përmendën një herë ishin kullotat e përbashkëta, përvoja në blegtori, bujaria dhe mikpritja e komunitetit si edhe topologjia.

Aspektet e treta më tërheqëse ishin forca punëtore e kualifikuar ose e lirë (20%), klima e mirë (16%), niveli ekonomik (12%), solidariteti i komunitetit, mjedisi, blegtorja, pyjet e kullotat (secili nga 8%), të ndjekura nga përvoja në mbledhjen dhe mbjelljen e lajthive.

Tre faktorët më pengues (P. 31) Infrastruktura e dobët ishte faktori më i rëndësishëm i përmendur që pengonte zhvillimin e biznesit (60%), i ndjekur nga mungesa e kullotave dhe lëndinave si edhe fuqia e ulët blerëse (secila nga 12%), mungesa e tregtisë (8%), çmimet e larta dhe mungesa e projekteve të zhvillimit (secila përmendur një herë).

Fuqia e ulët blerëse ishte faktori i dytë më i rëndësishëm i përmendur (28%), i ndjekur nga mungesa e tregut dhe tregtisë, përfshirja e 'feritza' (20%), cilësia e bagëtisë (12%), çmimet e larta, infrastruktura dhe mungesa e mbështetjes nga shteti (secila nga 8%), mungesa e përpunimit, largësia e madhe nga zonat qytetëse, mungesa e hoteleve dhe projekteve të zhvillimit.

Faktorët e tretë më të rëndësishëm të përmendur më shpesh ishin çmimet e larta, fuqia e ulët blerëse, mungesa e tregtisë, një dietë e çekuilibruar dhe infrastruktura e dobët, duke përfshirë rrugët e këqija dhe mungesa e ujitjes (secila nga 12%), të ndjekura nga 'dimri', mungesa e politikave mbështetëse. Konkurrenca e pandershme dhe mungesa e profesionalizmit dhe e vlerave historike lokale u përmendën nga një herë secila.

Ndryshime në sipërmarrje përgjatë tre viteve të fundit (P. 32) Thua jse gjysma e të anketuarve (40%) mendonin që mjedisi i sipërmarrjes kishte mbetur i pandryshuar përgjatë tre viteve të fundit, një e treta (32%) mendonin që ishte përmirësuar dhe vetëm 8% mendonin që ishte përkeqësuar. Pesë të intervistuar nuk iu përgjigjën pyetjes.

Tre veprimtari që kontribuonin në zhvillimin ekonomik në komunë (P. 33) Veprimtaritë kryesore që të anketuarit do të ndërmermin drejt ndihmës për përmirësimin e ZhEV do të ishin rritja e prodhimit (24%), të ndjekur nga përpunimi i prodhimeve bujqësore (16%), përmirësimi i infrastrukturës (12%) dhe përmirësimi i cilësisë së bagëtisë (secila nga 8%). Secili nga të anketuarit shënoi rritjen e cilësisë së prodhimit, rritjen e troftës, shërbimin ndaj traditës në prodhim, zhvillimin e turizmit, rritjen e zonave të mbjella, ruajtjen e çmimeve të qëndrueshme, frutikulturën, tregun unik dhe nismat (që specifikuan edhe dëshirën të dytën dhe paratë, nëse kanë mundësi, si të tretën).

Veprimtaria e dytë më e përmendur për të ndihmuar ishte rritja e prodhimit (20%), e ndjekur nga rritja e cilësisë së prodhimit dhe krijimi i kontratave (16% secila), puna me mjedisin dhe sigurimin e sipërmarrjes (secila nga 8%). Veprimtari të tjera që u përmendën ishin rritja e zonave të mbjella, përmirësimi i higjienës, mbjellje dhe kultivimi i bimëve mjekësore, rritja e numrit të kalemave të mbjella dhe rritja e tregtisë.

Veprimtaria e tretë më e rëndësishme e përmendur ishte rritja e prodhimtarisë (20%), e ndjekur nga sigurimi i sipërmarrjes (12%) dhe krijimi i kontratave me zona të tjera. Veprimtari të tjera që u përmendën një herë rrokjin përfshirjen e komunitetit në projektet e zhvillimit, zhvillimin e turizmit, prodhimin e ushqimeve organike, përmirësimin e cilësisë së prodhimit, rritjen e numrit të punëtorëve, përmasat e zonave të mbjella, kontrollin e cilësisë, afrimin e produkteve të konsumatori, përmirësimin e kushteve të shkollimit për fëmijët, përmirësimin e bagëtive, të tokës dhe bujqësisë.

Përshkrimi i bazës ekonomike në komunë përgjatë pesë viteve të fundit (P. 34) Qëndrimi më i përbashkët se si kishte ndryshuar ekonomia përgjatë pesë viteve të mëparshme ishte që kishte treguar ngritje të ngadaltë (68%). 12% e të anketuarve mendonin që kishte treguar rritje të konsiderueshme, 8% mendonin që kishte mbetur e njëjta apo kishte treguar pak rënie ndërsa një i anketuar mendonte se kishte pësuar rritje të shpejtë.